



QËNDRIME

**Shtatë pikat
e Memorandumit**



Një grup intelektualësh shqiptarë në Maqedoni kanë nisur të firmosin nga një memorandum me shtatë pika, ku mes kërkesave është ndryshimi i Kushtetutës së vendit, thirrja që interesat e shqiptarëve të mos mbahen peng i "stabilitetit dhe paqes" dhe integrimi kombëtar si prioritet edhe para BE-së.

Fq.2

GLOBI

**Logjika e
luftës në Siri,
sulm me gaz
dhe bom-
bardime**

Fq.13

RAJON

**Serbinë e
kërcënojnë më
luftë e pushkë,
Listës Serbe i
bien në gjunjë**

Fq.12



NDRYSHIME LIGJORE PËR "DËSHMITARËT E MBROJTUR"

**ARDHMËRI E VËSHTIRË PËR
FUNKSIONARËT E KORRUPTUAR**



Ligjet reformuese, ai për mbrojtjen e dëshmitarëve, Ligji për ndjekjen e komunikimeve dhe Ligji për Agjencinë operative-teknike, të enjten në Parlament u miratuan në lexim të dytë, me shumicën e kualifikuar të votave edhe atë prej 86 respektivisht 84 votave. Përmes ligjit për "dëshmitarë të mbrojtur" i jepet kompetencë Prokurorisë Speciale që ajo vetë të përcaktojë personat për dëshmitarë të mbrojtur e jo siç ishte më parë ku me kërkesë të saj personat se kush të jetë dëshmitar i mbrojtur ia përcaktonte Prokuroria Publike

Fq.3

Vetëdijësimi i nxënësve – komponentë e rëndësishme

Shkup, 12 prill – Rreth 5500 nxënës të vitit të parë dhe të dytë gjimnaz do t'iu nënshtrohen së shpejti testeve ndërkombëtare të PISA-s, për të matur shkallën e diturisë që kanë nxënësit e moshës 15 vjeçare për lexim, matematikë dhe shkenca natyrore. Qëllimi final i këtyre testeve të certifikuar ndërkombëtarisht nga OCDE-ja është vlerësimi sa më real i cilësisë arsimore për vendet pjesëmarrëse, ndërsa Maqedonia

do të jetë një prej 70 shteteve që ka kërkuar organizimin e testeve PISA 2018. Dy javë para fillimit, kërret e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), përfaqësues të Qendrës Shtetërore të Provimeve (QSHP) dhe USAID-it realizuan takim me drejtorët e gjimnazeve për të sensibilizuar nevojën e trajtimit me seriozitet të këtij procesi, respektivisht motivimit të nxënësve për të dhënë...

Fq.4



QËNDRIME

INTELEKTUALËT SHQIPTARË
DHE E ARDHMJA E MAQEDONISËSHTATË PIKAT E
MEMORANDUMIT

Një grup intelektualësh shqiptarë në Maqedoni kanë nisur të firmosin nga një memorandum me shtatë pika, ku mes kërkesave është ndryshimi i Kushtetutës së vendit, thirrja që interesat e shqiptarëve të mos mbahen peng i “stabilitetit dhe paqes” dhe integrimi kombëtar si prioritet edhe para BE-së.

Intelektualët firmëtarë të këtij memorandum i japin fillimisht arsytet që i shtynë për të dalë me këto shtatë kërkesa. Së pari rendisin krizën e thellë dhe të gjithanshme në të cilën ndodhen shqiptarët në Maqedoni, nëpërkëmbjen e vazhdueshme që u bëhet dhe përjashtimi nga vendimarrjet për çështje të rëndësishme për të ardhmen e vendit.

Pika e parë e memorandumit kërkon ndryshimin e Kushtetutës për t’iu përshtatur realitetit të një shoqërie multietnike.

“E konsiderojmë si të domosdoshme ndryshimin e Kushtetutës ekzistuese, si jodetyruese dhe për shqiptarët për vetë faktin se përcakton IRJM si “shtet kombëtar i sllavo-maqedonasve” ku jetojnë edhe bashkësitë e tjera etnike, në mesin e të cilëve janë dhe shqiptarët”, thuhet aty.

Intelektualët shqiptarë përjashtojnë çdo formë referendumi nën këtë Kushtetutë.

Në pikën e dytë konsiderohet si i domosdoshëm ndryshimi i emrit të Maqedonisë dhe kërkohet përfshirja e faktorit shqiptar në këtë proces.

“Gjykojmë se injorimi i të drejtave të shqiptarëve për të marrë pjesë në zgjidhjen e çështjes së emrit është shkelje flagrante e të drejtave të shqiptarëve. Çdo propozim për emrin nga ana e përfaqësuesve shqiptarë në pushtet duhet t’i paraprijë një diskutimi publik, vijojnë kërkesat e intelektualëve.

Pika e tretë i drejtohet klasës politike shqiptare në Maqedoni, Kosovë e Shqipëri.

“Thesojmë domosdoshmërinë e integrimin e shqiptarëve si komb si prioritar, para çdo lloji integrimi tjetër, përfshirë dhe atë të në BE. Askush nuk ka të drejtë t’ua mohojë shqiptarëve të drejtën për integrimin e tyre si komb, duke u imponuar integrimin e tjera, si zëvendësim, përfshirë këtu edhe BE. BE nuk është garanci për integrimin e shqiptarëve dhe eliminimin e kufijve mes tyre. Asgjë nuk justifikon copëzimin kulturor, arsimor, ekonomik të kombit, gjë që krijon vakuum, i cili me lehtësi plotësohet nga ndikime të huaja, të rrezikshme për identitetin e shqiptarëve në Maqedoni”, thuhet më tej.

Në pikën e katërt të memorandumit qortohen qëndrimet, sipas tyre, në dëm të interesave të shqiptarëve për hir të paqes dhe stabilitetit të rajonit.

Në pikën pesë, memorandum i thotë se axhendat e shqiptarëve nuk mund të mbahen peng nga një grusht politikësh shqiptarë të korruptuar.

Në pikën gjashtë, intelektualët denoncojnë, sipas tyre, shantazhet që u bëhen politikanëve shqiptarë në Shkup me dosjet korruptive, të cilat pala maqedonase i përdor për t’i kontrolluar.

Në fund, memorandum i sjell Zvicrën si shembull që duhet të ndjekë Maqedonia.

“Konfederata zvicerane në aspektin e politikave linguistike është një aparat i çuditshëm: shtatë milionë banorë flasin 4 gjuhë të ndryshme, me status të barabartë zyrtar: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retoromanisht. Madje, dhe për emërtimin e vendit përdoret latinishtja Confoederatio Helvetica, në mënyrë që t’i iket favorizimit të njëres prej katër gjuhëve zyrtare të Zvicrës. Nga kjo zgjidhje linguistike, Zvicra e vogël asgjë nuk humbet ngaqë nuk ka një gjuhë zyrtare të vetme. E, nga ana tjetër, në Maqedoninë po ashtu të vogël, me 2.2 milionë banorë, ku së paku 1/3 e popullatës janë shqiptarë, ka një ligj vetëm për përdorimin e gjuhës maqedonase si gjuhë zyrtare në të gjithë territorin e shtetit, por nuk ka një ligj që edhe gjuhës shqipe t’i krijonte një status të tillë të barabartë”, deklarojnë intelektualët.

Memorandum i mbyllet me vendosmërinë e intelektualëve shqiptarë për të denoncuar politikën në dëm të shqiptarëve dhe gatishmëria për gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare të çështjes shqiptare në Maqedoni.

LDK po kalon nga
demokracia në “sallamadi

“Një kryetar komune që sapo e ka filluar mandatin e ri, dashka ta lerë punën që bën tash, për t’u bërë kryeministër! Një politikan serioz para se të vendos se për cilin post do të garojë, duhet ta njoh veten dhe të sillet në harmoni me ambiciet personale që pastaj të jetë në gjendje t’i përmbush obligimet ndaj publikut. Ky Gazi i Pejës, tash po del të jetë edhe gazi (qesharak)i LDK-së! Nuk është serioze që ta lesh mandatin e kryetarit të komunës ku je zotuar t’i realizosh projektet tua dhe t’i përmbushësh premtimet para qytetarëve, vetëm pse tash të është shtuar oreksi për një pozitë më të lartë. Demokracia nuk është sallamadi, por i ka do rregulla dhe do kode morale në bazë të të cilave shquhesh si personalitet dhe fiton mbështetjen e publikut. E kryen mandatin e kryetarit dhe pastaj pret rendin për një post tjetër. Nëse ke aspiruar postin e kryetari të komunës për ta përdorur si trampolinë që të këtcësh në karriken e kryeministrit, atëherë ke genjyer publikun. Partitë politike dhe shteti i Kosovës nuk e kanë luksin që të bëjnë zgjedhje komunale për të përmbushur interesa ekskluzivisht individuale.

Gazmend Muhaxheri duhet të frenojë pak! Në anën tjetër edhe Isa Mustafa, doli po aq qesharak me kumtesën e tij për rritje të unitetit në parti. Dy zyrtarë të partisë e vizituan atë privatisht, siç vizitohet çdo i sëmurë në shtëpinë e tij. Ky shkroi në facebook se ishte takuar me dy këta zyrtarë të partisë së tij. Nuk mund të bësh këso kumtesash pëderisa i ke prituri ata privatisht, si miq, nga pozicioni i njeriut të sëmurë!”, ka shkruar në profilin e tij në Facebook, Ilir Loshi.

Rrena dhe manipulimi
si strategji

“Rrena dhe manipulimi publik është shndërruar në doktrinë dhe strategji për me tubue një grusht vota ma shumë, sidomos nga Lëvizja Vetëvendosje.

Një bashkëpjesëmarrëse në takim me zyrtarë të BE-së në Prishtinë - për fatin e të vërtetës - sapo na dëshmoi se Deputetja e VV Fitore Pacolli ka rrejtë ashikare, kur deklaroi se zyrtarë të BE-së i paskan thënë se sivjet nuk ka viza për kosovarët!?

Kur një deputete e zgjedhur nga populli e rren atë pa iu dridh çerpiku, atëherë duhet t’ia kujtojmë asaj proverbin që thotë: Nuk më vjen keqe që m’ke rrejtë por që s’do të besoj më kurrë!!!

Manipuluesit nuk e kanë vendin në Kuvend!” ka shkruar në profilin e tij në Facebook, Halil Matoshi.

MEDIACitate

SHBA- Rusi, aktivë me
telefon për Sirinë

“Shtetet e Bashkuara dhe Rusia janë duke biseduar për të parandaluar një përplasje ushtarake eventuale në Siri, njoftoi Kremli. Zëdhënësi i Kremilit Dimitri Peskov e konfirmoi se dyja palët po përdorin linjat telefonike për të parandaluar incidentin.

I pyetur rreth lidhjeve telefonike mes SHBA-së dhe Rusisë, Peskov tha “Linja ekziston dhe është aktive.” Linja telefonike është përdorur për të parandaluar një përplasje direkte ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe trupave ruse të cilët janë të përfshirë në konfliktin në Siri, ku Rusia po e mbështet regjimin e Assadit, ndërsa Shtetet e Bashkuara mbështesin forcat opozitare siriane. Një pjesë e madhe e mercenarëve rusë ndihmojnë mbështetësit e Assadit”.

(“The Guardian”, 12 prill)

Scott: Asociacioni të bëhet
sipas ligjeve të Kosovës
dhe të Serbisë

Ambasadori amerikan në Serbi, Kyle Scott ka deklaruar se SHBA-ja përkrah hapat e ndërmarrë për formimin e Asociacionit të Komunave serbe dhe se ajo mendon se Marrëveshja e Brukselit për implementim është në përputhje me ligjet e Kosovës dhe të Serbisë.

“Përkrahim hapat që janë ndërmarrë kohë më parë pas një kohe të gjatë për formimin e AKS-së. Presim që bisedimet të jenë të vështira, por ky është hap i rëndësishëm”, ka thënë Scott në konferencë shtypi ku ishte i pranishëm edhe ministri serb i Punëve të Brendshme Nebojsa Stefanoviq.

Në pyetjen cili është qëndrimi i SHBA-së që në ç’mënyrë të formohet AKS, sipas Marrëveshjes së Brukselit apo sipas ligjeve të Kosovës, Scott, ka thënë se Marrëveshja e Brukselit flet për harmonizimin ligjeve të Kosovës e të Serbisë.

“Mendoj se pyetja juaj është paksa kundërtshënëse, sepse në Marrëveshjen e Brukselit flet se ligjet do të harmonizohen me ligjet e Kosovës dhe të Serbisë”, ka thënë Scott.

Sipas fjalëve të tij, i gjithë qëllimi është që serbët në Kosovë të ndihen këndshëm dhe të kenë kontrollin e jetës së vet të përditshme ndërsa synimi i fundit është normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet dy palëve. Ministri serb i Punëve të Brendshme të Serbisë Nebojsa Stefanoviq ka pasur qëndrim të kundërt. “Marrëveshja e Brukselit duhet të zbatohet ashtu si është nënshkruar”, ka thënë ai.

(“Blic”, 12 prill)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

KUPTIMI I ÇOROVANIT

Çorovan shpjegohet me etimologjinë sllave Çoro i zi, i nxirë. Ngase aty kur bie shi nxihet e bëhet sterrë. Prapashtesa Van, emër njeriu. Mbase e ka marrë nga ndonjë person me këtë emër që ishte i zi. Në Mollas kanë jetuar familje rome. Ata kanë ushtruar profesionin e kovaçit. Banorëve u duhej kalituri plori i parmendës, u duhej mprehur kazma e lopata u duhej masha e kacia e dhjetëra sende të tjera metalike e këto

bëheshin për bukuri vetëm nga dora e tyre. Qela është trajta e rregullt shqipe qelëza. Është më e mundshme, që ky emër të ketë burimin e tij që në kohët e lashta dhe të ketë qenë një vend i banueshëm.

Qela është një vend natyror i pakalueshëm, por sot aty gjarpëron një rrugë automobilistike e hapur në vitin 1970, që lidh Dragotin e Sulovës me Mollasin.

Ligjet reformuese, ai për mbrojtjen e dëshmitarëve, Ligji për ndjekjen e komunikimeve dhe Ligji për Agjencinë operative-teknike, të enjten në Parlament u miratuan në lexim të dytë, me shumicën e kualifikuar të votave edhe atë prej 86 respektivisht 84 votave. Përmes ligjit për "dëshmitare të mbrojtur" i jepet kompetencë Prokurorisë Speciale që ajo vetë të përcaktojë personat për dëshmitarë të mbrojtur e jo siç ishte më parë ku me kërkesë të saj personat se kush të jetë dëshmitar i mbrojtur ia përcaktonte Prokuroria Publike.

NDRYSHIME LIGJORE PËR "DËSHMITARËT E MBROJTUR"



ARDHMËRI E VËSHTIRË PËR FUNKSIONARËT E KORRUPTUAR

është propozuar fillimisht nga LSDM-ja, tha deputetja, Stamenovska.

Ndërkaq nënkryetarja e Parlamentit të Maqedonisë Frosina Ramenki pasi u votua ligji për formimin e Agjencien Operative-teknike tha se për herë të parë në Maqedoni krijohet një garancë e madhe ligjore në sferën e sigurisë. "Nuk dua të replikoj me kolegun Trajço Dimkov por dua të potencoj faktin se përmes këtyre ligjeve për herë të parë në Maqedoni krijohet garancia më e madhe ligjore në sferën e sigurisë. Kjo është një mundësi e mirë që Institucionet qeveritare dhe ato të sigurisë të bëjnë atë që duhet bërë që të mos përsëritet e kaluara me çka dhe do të krijohet një siguria më e madhe për të gjithë qytetarët e Maqedonisë", tha Frosina Ramenki. Ndryshe përveç këtyre ligjeve pas vazhdimet të dytë të seancës plenare është pritur të miratohet edhe ndryshimet e ligjit për Gjykatat dhe Ligji për Këshillin Gjyqësor gjithashtu me votimin edhe të deputetëve të VMRO-së.

Ndryshe Ligji për dëshmitarë të mbrojtur ka mbi një vit që është kërkuar të miratohet nga ana e

Prokurores Speciale Katica Janeva por që është refuzuar vazhdimisht nga ana e VMROI dhe kur ishte në pushtete edhe gjatë këtyre muajve sa është në opozitë. Gjatë Qeverisë teknike LSDM ngriti iniciative në Parlament por që nuk kishte numra të mjaftueshëm për miratimin e këtij ligji. Përmes ligjit për dëshmitarë të mbrojtur jepet kompetencë Prokurorisë speciale që ajo vetë të përcaktojë personat për dëshmitarë të mbrojtur e jo siç ishte më parë ku me kërkesë të saj personat se kush të jetë dëshmitar i mbrojtur ia përcaktonte Prokuroria Publike. Sipas e shume ekspertëve dhe sipas vetë asaj që ka thënë Prokuroria speciale Katica Janeva, përmes këtyre ndryshimeve ligjore do të mundësohet zbardhja e shumë rasteve të diskutueshme në opinion si rasti "Monstra" dhe raste tjera si dhe të arrihet më shpejtë deri tek përfundimet gjyqësore të shumë rasteve ne procedurë ku akuzohen ish funksionarë të lartë të VMRO-së përfshirë dhe ish liderin e saj dhe ish kryeministrin Nikolla Gruevski. Miratimi i ligjeve reformuese si dhe afrimi i qëndrimeve rreth çështje së emrit, pritet të jenë faktor ven-

dimtar që Maqedoni më 18 prill të merr rekomandim pozitiv nga ana e Komisionit Evropian. Një ditë pas publikimit të raportit Përfaqësuesja e lartë për politikë të jashtme dhe siguri të BE-së Federika Moggerini, më 19 prill do t'i drejtohet Parlamentit të Maqedonisë gjatë vizitës që do të realizojë në Shkup me komisionerin për zgjerim dhe fqinjësi të mirë Johannes Hann. Vizita e tyre vjen një ditë pas publikimit të raportit të progresit të Komisionit Evropian, nga i cili Qeveria pret rekomandim të pastër për çeljen e negociatave. Për përmbajtjen e raportit dhe çështjet tjera të procesit integruar, është biseduar edhe në takimin e djeshëm në Bruksel mes Mogerinit dhe zëvendës kryeministrit për çështje Evropiane Bujar Osmani. Në këtë takim, Osmani e ka njoftuar shefen e diplomacisë Evropiane me punën e bërë në zbatimin e planit 3-6-9, si dhe për pengesat tjera në rrugën e Euro integritimit. Në periudhën e ardhshme sipas Osmanit, pritet edhe zgjidhje për çështjen e emrit me Greqinë, pas çka sipas tij do të mënjanohej të gjitha pengesat për inkuadrimin e Maqedonisë në NATO dhe BE.

Turqia rrëzon një avion grek

Një avion i flotës ushtarake të Greqisë është rrëzuar sot në detin Egje pranë ishullit Skyros, shkruan Express.co.uk

Sipas burimeve të medias greke, avioni që u rrëzua ka qenë një nga dy avionët që u dërguan për të përcjellë një avion të Turqisë gjatë një patrullimi në mëngjesin e së enjtes.

Megjithatë, raportohet që avioni Mirage 2000-5 nuk ka qenë i përfshirë në konflikt me avionin turk, por ende nuk dihet shkaku i rrëzimit të tij apo fati i pilotit grek. Forca ajrore greke ka deklaruar që e ka humbur kontaktin me avionin në orën 12:15 të ditës së sotme, ndërsa është bërë e ditur që operacioni për kërkimin e pilotit ka filluar.

Ky incident vjen në një kohë kur Turqia dhe Greqia janë të përfshira në një konflikt territorial që ka shkaktuar ashpërsimin e gjuhës mes zyrtarëve të të dy shteteve.

Sulmi mbi Sirinë, Trump ia dorëzon "shtafetën"

Francës



Presidenti Donald Trump reagoi sërish të enjten, duke thënë se sulmi ndaj Sirisë mund të ndodhë "shumë shpejt" ose "nuk mund të ndodhë", duke argumentuar se kurrë nuk ka dhënë ndonjë shenjë mbi kohën e hakmarrjes për sulmin e dyshuar me armë kimike, pavarësisht se një ditë më parë e bëri thujtë të pashmangshme një ndërhyrje ushtarake. SHBA, Franca dhe Britania kanë zhvilluar konsulta të gjera mbi një sulm të mundshëm ushtarak jo më vonë sesa fundi i kësaj jave. Një operacion i përbashkët, ndoshta me Francën kryesuese e jo Shtetet e Bashkuara, mund të dërgojë një mesazh uniteti ndërkombëtar mbi zbatimin e ligjeve parandaluese të armëve kimike dhe për të kundërshtuar mbështetjen ushtarake e politike të Rusisë e Iranit ndaj Sirisë. Presidenti francez, Emmanuel Macron tha të enjten se Franca ka prova të pakundërshtueshme se qeveria siriane ka sulmuar me gaz klorin, e për këtë arsye, Franca "nuk mund të tolerojë regjimin që mendojnë se gjithçka është e lejuar". Presidenti francez nuk ka nevojë për leje nga Parlamenti për një nisur një ndërhyrje ushtarake.

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 12 prill-Gjashtë ditë para publikimit të raportit të Komisionit Evropian për Maqedonisë, bashkëpunimi në grupet punës mes pozitë opozitë të enjten dha frytet e veta. Ligjet reformuese ai për mbrojtjen e dëshmitarëve, Ligji për ndjekjen e komunikimeve dhe ligji për Agjencinë operative-teknike, të enjten në Parlament u miratuan në lexim të dytë me shumicën e kualifikuar të votave edhe atë prej 86 respektivisht 84 votave. Deputetja e VMRO-DPMNE-së, Nevenka Stamenovska, vendimin e grupit të saj parlamentar për të votuar liget reformuese e arsyetoi me faktin se janë përfillur vërejtjet e VMRO-së ndërsa në lidhje me ligjin për dëshmitar të mbrojtur ajo theksoi se tani është më i mirë se sa ka propozuar LSMD që në fillim. "Në pajtueshmëri me propozimet të cilat i kemi propozuar, gjithsej 11, është bërë intervenim në ligjin ekzistues dhe mund të themi se drejtësia është vënë në vend. Ky ligj ndoshta nuk është ideal, por është më i mirë nga ai që

KOXIAS: SHOHIM PËRPARIM

Ministri i Jashtëm grek Nikos Koxias pas takimit të djeshëm në Ohër me homologun e tij Nikolla Dimitrov beson se do të zgjidhen gjitha problemet së shpejti.

"Falënderoj mikun tim, Nikollën për mikpritjen, pasi çdoherë kur takohemi diskutojmë për pyetjet e vështira. Me siguri se do të shihemi përsëri në Selanik më 3 dhe 5 maj, ndërsa më 11 të këtij muaji do të diskutojmë për të ardhmen e Evropës. Shohim përparim, veçmas në kornizën e bashkëpunimit të përbashkët. Si që përafrohemi ashtu edhe zgjidhim



problem. E bëmë atë hap pozitiv dhe shpresoj se do të lehtësojmë problemet e vështira", ka thënë

Koxias. Ministri i Punëve të Jashtme të Maqedonisë Nikolla Dimitrov pas

takimit me homologun e tij grek Niko Kocijas, deklaroi se në takim është biseduar për të gjitha çështjet, përfshirë edhe ato ku akoma ka dallime.

Ai tha se për herë të parë është folur edhe për kornizën kohore nëse arrihet marrëveshja. "Për një pjesë të tyre ka përparim, për një pjesë akoma ka dallime. Kemi folur për herë të parë për kornizën kohore dhe për hapat nëse arrihet marrëveshje si do të veprohet. Ishite bisedë me mirëkuptim për nevojat e tjetrit dhe sfida jonë se si shqetësimet për të dyja palët.

Ministria e Arsimit, Renata Deskovska dhe zëvendësministri Arbër Ademi bëjnë thirrje deri te shkollat të cilat do të bëhen pjesë e testeve ndërkombëtare PISA 2018 që ta marrin seriozisht testimin dhe ti motivojnë nxënësit që të japin maksimumin

Koha Laura PAPANIKU


Shkup, 12 prill – Rreth 5500 nxënës të vitit të parë dhe të dytë gjimnaz do t'iu nënshtrohen së shpejti testeve ndërkombëtare të PISA-s, për të matur shkallën e diturisë që kanë nxënësit e moshës 15 vjeçare për lexim, matematikë dhe shkencë natyrore. Qëllimi final i këtyre testeve të certifikuar ndërkombëtarisht nga OCDE-ja është vlerësimi sa më real i cilësisë arsimore për vendet pjesëmarrëse, ndërsa Maqedonia do të jetë një prej 70 shteteve që ka kërkuar organizimin e testeve PISA 2018.

Dy javë para fillimit, krerët e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), përfaqësues të Qendrës Shtetërore të Provimeve (QSHP) dhe USAID-it realizuan takim me drejtorët e gjimnazeve për të sensibilizuar nevojën e trajtimit me seriozitet të këtij procesi, respektivisht motivimit të nxënësve për të dhënë më të mirën e mundshme.

Ministria Renata Deskovska dhe zëvendësministri Arbër Ademi, kërkuar nga drejtorët dhe mësimdhënësit që të motivojnë nxënësit dhe të vetëdijësojnë ata për rëndësinë e këtyre testeve. "Ka pasur shumë raste, gjatë testeve të kaluara kur nxënësit nuk e kanë marrë seriozisht testimin, meqë nuk marrin nota dhe rezultatet nuk ndikojnë në suksesin e tyre në shkollë. Mirëpo, këto rezultate janë shumë të rëndësishme për të vlerësuar nivelin e cilësisë të arsimit, prandaj duhet të angazhohemi për rezultate sa më reale", thotë ministria Deskovska, ndërsa thotë se pritjet nga PISA

PËR DY JAVË PISA 2018, NË MAQEDONI

VETËDIJËSIMI I NXËNËSVE - KOMPONENTË E RËNDËSISHME



2018 janë që vendi të del nga rrethi i shteteve me nivelin më të ulët të dijeve. Në testimet e fundit (PISA 2015) Maqedonia gjendej në fund të listës bashkë me Tunizinë, Kosovën, Algjerinë dhe Republikën Dominikane. "Synimi jonë është që ta braktisim këtë shoqëri", u shpreh ajo. Sakaq, zëvendësministri Arbër Ademi nënvizon nevojën e komunikimit më të mirë. "Në dy raste kur Maqedonia ka marrë pjesë në testimet ndërkombëtare të PISA-s për fat të keq nuk janë arritur rezultate të kënaqshme, prandaj takim i sotëm është që të organizohemi, të koordinohemi më mirë për të fituar pasqyrën reale të asaj se ku qëndrojmë si shtet në hartën globale arsimore", shprehet Ademi. Faktorët që ka sjellë deri te këto rezultate, thotë se janë të shumta, një prej të cilave edhe demotivimi i nxënësve. Prandaj i zhvillojmë këto aktivitete, me qëllim që të mos kemi raste kur nxënësit nuk i plotësojnë testet deri në fund, plotëson Ademi, duke shtuar se nuk ka nevojë as të sforcohemi

për të fyrrë rezultate. "Dëshirojmë të eliminojmë të gjithë faktorët që cilët nuk japin pasqyre reale, por nuk dëshirojmë as të fryhen rezultatet dhe në këtë mënyrë të mos pasqyrojnë gjendjen reale", shprehet zëvendësministri Ademi

Ministria Deskovska, shpjegoi gjithashtu se në një të ardhmen të shpejtë rezultatet e PISA-s dhe testeve tjera ndërkombëtare, të

cilat do të tregojnë nxënësit e shkollave veç e veç, do të ndikojnë drejtpërdrejt edhe në rangimin e shkollave. Shkolla e ranguar më mirë, gjatë 10 viteve të ardhshme do të jetë institucioni ku krahas diplomës do të ndahen edhe certifikata me numrin e pikëve të fituara gjatë rangimin, ndërsa nxënësit e këtyre shkollave do të kenë benificione përkatëse. Gjithë kjo, pasi

në fokus të reformave dhe propozim-ligjit për arsim të mesëm (i cili do të nis të përgatitet së shpejti) do të jetë përmirësimi i cilësisë. Kjo është shumë e rëndësishme edhe sipas përfaqësuesit të USAID-it në Shkup, Benxhamin Perks.

Një hulumtim që ka bërë Universiteti i Millburnit në Austri lidhur me nivelin e shkollimit, sikurse transmetoi Perks ka treguar se arsyeje kryesore nuk janë as programet mësimore, as kushtet e objekteve shkollore por është cilësia e shkollimit. Por krahas cilësisë së shkollimit është shumë e rëndësishme që nxënësit të kenë kujdes cilësor nga familja dhe të përfshihen në arsimin parashkollor. Të dhënat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, lidhur me shëndetin psikik të fëmijëve janë dëshpëruese për Maqedoninë. 52 për qind e fëmijëve të moshës nga 2 deri 14 vjet përjetojnë ndëshkime fizike dhe kjo reflektohet negativisht në lidhjet emocionale që ata duhet të ndërtojnë më pas.

SKANDALI I ILIESKIT NUK KOMENTOHET NGA MASH

Skandali me inspektorin e arsimit Zoran Ilieskin, i cili përmes profilit të tij në "facebook" deklarohet kundër dygjuhësisë në Maqedoni, nuk komentohet në detaje nga drejtuesit e MASH-it. Ministria Deskovska thotë se nuk e ka të njohur rastin dhe kontesti në të cilin ka ndodhur ngjarja, pra nëse bëhet fjalë deklarata private, rrejet sociale, e kështu me radhë. "Ka gjëra të cilat janë në sferën e lirisë së shprehjes, por nëse bëhet fjalë për gjuhën e urrejtjes atëherë kemi të bëjmë me rast tjetër. Nëse nuk ka gjuhë të urrejtjes kemi të bëjmë me të drejtën e secilit të shprehet për gjërat që ndodhin në shoqëri", deklaroi ministria. Qëndrim të ngjashëm ka edhe zëvendësministri, Ademi/. Ai, thotë se nuk dëshiron të komentojë detajet e statusit të të shpërndarë përmes rrjeteve sociale, por dëshiron të theksojë se çdo instiutiacion

dhe çdo individ është i detyruar të sillet dhe të veprojë konform dispozitave ligjore. "Pa komentuar më tepër, inspektorin dhe çdo kush tjetër duhet të harmonizojë veprimet dhe sjelljet e tyre me dispozitat ligjore", shprehet ai. Publikimi i qëndrimeve kundër dygjuhësisë, nëse jo për shkelje ligjore ka hapur dilema për kredibilitetin dhe etikën profesionale të inspektorëve arsimor, të cilët duhet të jenë në komunikim të vazhdueshme me shkollat, ku përveç maqedonishtes mësohen edhe në gjuhë të tjera. Ata kanë kërkuar nga MASH të merr masa ndaj veprimeve të atilla të cilat dëmtojnë autoritetin e Ministrisë dhe atyre që duhet të mbikëqyrin rregullin dhe cilësinë e shkollave. Ilievski, është i punësuar si inspektor arsimor pikërisht në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit, i cili është në kompetenca të MASH-it.

Gjukanoviçi urgjentisht të heq dorë nga retorika luftënxitëse

Asociacioni i Mediave të Europës Juglindore përmes një komunikate për shtyp ka dënuar retorikën luftënxitëse të kandidatit presidencial, Milo Gjukanoviçi, në kuadër të fushatës për zgjedhjet presidenciale që pritet të mbahen të dielen në Mal të Zi



Podgoricë, 12 prill - „Milo Đukanović, kandidat i zgjedhjeve presidenciale në Mal të Zi dhe shef gati tre dekatësh i regjimit malazias, dje ka vazhduar me praktikën e dështuar të tij në fiksimin e caqeve

mbi gazetarët dhe mediat e lira e të pavarura.

Personi që pretendon të bëhet Presidenti i vendit, aspirant për anëtarësim në BE dhe anëtar i

NATO-s, në asnjë mënyrë nuk ka guxuar t'ia lejojë vetes t'i kualifikojë „fashiste“ dhe „reketuese“ mediat e lira e profesionale, vetëm për faktin se atij nuk i pëlqen poli-

tika e tyre redaktuese, që për çdo ditë merren me denoncimin e korrupsionit, fajtor të të cilit janë njerëz nga rrethi i tij.

Kualifikime të tilla në adresë të gazetës VIJESTI, si medie e pavarur dhe anëtar i Asociacionit të Mediave të Europës Juglindore, për të satën herë ka përsëritur Milo Gjukanoviçi, duke fiksuar si cak për linçim edhe gazetarët, redaktorët dhe gjithë të punësuarit në këtë medie. E përkujtojmë Gjukanoviçin se kjo dhe retorika të ngjashme, në të kaluarën, ishin të shoqëruar me 25 sulmbi mbi të punësuarit dhe pronën e VIJESTI-

it, përfshi rrahjet, sulmet me bombë, zjarrvënja në automobil, ndërkohë që deri më tani vetëm një rast është ndriçuar pjesërisht.

Për këtë arsye kërkojmë nga Gjukanoviçi që urgjentisht të heq dorë nga retorika luftënxitëse dhe thirrjet e hapura për linçim drejtuar mediave të pavarura, të lira dhe të profesionale, sepse në të kundërtën do të jetë vet përgjegjës për çfarëdo sulmi potencial mbi të punësuarit e VIJESTI-it dhe pronën e saj“, thuhet në komunikatën e Asociacionit të Mediave të Europës Juglindore, nënshkruar nga drejtori ekzekutiv Vuk Maraš.

VDEKSHMËRIA E FOSHNJAVE TË PORSALINDURA

PËRGJEGJËS - INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Në afat sa më të shkurtër do të përgatiten udhëzimet për monitorimin e kushteve të rrezikshme gjatë shtatzënisë, kurse për të parandaluar masat e vdekshmërisë të foshnjat, duhet të merren masa konkrete (kontrolli i nënave shtatzëne, përmirësimi i kushteve, rritja e kuadrit të mirëfilltë, etj.)

Koha

Delvina KËRLUKU

Shkup, 12 prill - Specializimi i kuadrit të mjekëve, rritja e numrit të gjinekologëve amë, ngritja e cilësisë së shërbimeve në maternitet etj, janë një ndër masat që duhet të merr Ministria e Shëndetësisë, për parandalimin e vdekshmërisë së foshnjave të porsalindur. Sa i përket vdekjes së 35 foshnjave të porsalindura në tre muajt e pare të këtij viti, në Klinikën Universitare të Gjinekologjisë dhe Obstetrikës në Shkup, ministri të Shëndetësisë, Venko Filipçe, vlerëson se mungesa e dhomave të lindjes, kujdesit joadekuat dhe jo në kohë kujdesi i shëndetit të nënave, pasha e tyre e ulët e lindjes dhe lindjet e parakohshme janë shkaktarët kryesor të vdekjes së tyre.

Ministri Filipçe shton se në afat sa më të shkurtër do të përgatiten udhëzimet për monitorimin e kushteve të rrezikshme gjatë shtatzënisë, si dhe udhëzimet klinike për trajtimin e sëmundjes së sepsës, problemet me koagulimin e gjakut gjatë shtatzënisë dhe gjatë punës, udhëzimet për trajtimin e presionit të lartë të gjakut të nënës, kombinuar me nivele të larta të proteinave të gjakut.

MASAT PARANDALUESE

Ndësa nga Spitali "Nënë Tereza" në Çair, zëdhënësi Ilir Shurdhani thotë se arsytet e vdekshmërisë së foshnjave të porsalindura vijnë si rezultat e lindjes së parakohshme, si dhe infeksionet e ndryshme.

Për të parandaluar masat e vdekshmërisë të foshnjat duhet të merren masa konkrete si kontrolli i nënave shtatzëne,

përmirësimi i kushteve, rritja e kuadrit të mirëfilltë, etj.

"Sa i përket arsyeve për vdekshmërinë e foshnjeve ka shumë, por ne do të veçojmë disa. Ndër më të shpeshtat me të cilat ballafaqohemi janë lindjet e parakohshme, sidomos ato para javës 28, infeksionet e pa determinuara gjatë periudhës së shtatzënisë, anomalit kongjenitale. Kurse, sa i përket masave për previnim do të veçonim organizimin adekuat të shëndetësisë primare, detektimin e hershëm të shtatzënisë me rrezik të lartë si dhe menanxhimin adekuat dhe në kohë të të njëjtave, kontroll të regullt tek mjekët amë apo në spitalet ku gravitojnë, ngritja e nivelit shëndetësor tek gratë shtatzëna, rritja e numrit të punësuarve, përfshi personelin e mesëm dhe mjekët", tha Shurdhani për gazetën "Koha".

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave, si një tregues kyç për të matur shëndetin e përgjithshëm të të gjithë popullsisë, është më e lartë në vendet ku ka dallime të dukshme në gjendjen shëndetësore të popullatës dhe në vendet të cilat përballen me kushtet sociale, kulturore dhe politike të pafavorshme.

Rosana Janevska nga shoqata "Hera", asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim, duke folur për këtë dukuri vlerëson se në të kaluarën shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve në vend ka qenë vazhdimisht e lartë në mesin e grave rome, dhe në vitin 2016 ishte më e lartë në mesin e grave të nacionalitetit shqiptar. Sipas saj në Maqedoni ka pengesa të shumta për të hyrë në shërbimet e shëndetit riprodhues, duke përfshirë në veçanti bar-

rierat institucionale ose mungesën e qasjes në shërbime për shkak të shpërndarjes së pabarabartë gjeografike të gjinekologëve në vend dhe pengesat financiare, siç është pagesa e paligjshme e kontrolleve gjinekologjike që nuk duhet të paguhet, por duhet të ngarkohen me këtë në zyrat e gjinekologëve amë.

"Përgjegjësia në asnjë mënyrë nuk mund t'i atribuohet nënave por institucioneve shëndetësore të cilët duhet të marrin masa pro-aktive për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës dhe për të lehtësuar qasjen në shërbimet shëndetësore", thonë nga shoqata "Hera", për gazetën "Koha".

AMBIENT I NDOTUR STIMULON VDEKSHMËRINË

Për aspektet e ndryshme të shkaqeve të vdekshmërisë dhe masave parandaluese, kanë folur edhe përfaqëuesit e Lëvizjes "Nëna dhe Fëmija".

"Lëvizja "Nëna dhe Fëmija", aspektin e vdekshmërisë së foshnjave mund ta analizoj më tepër nga ndikimi i ndotjes së ambientit, ajrit në veçanti, gjë që gjithmonë e kemi cekur dhe elaboruar. Padiskutim që ndotja e ajrit, dhe e ambientit në përgjithësi ka impakt të lartë në shëndetin e popullatës, dhe sipas statistikave për grupmosha të ndryshme dëshmohet qartë që ndotja është e lidhur ngushtë me shëndetin e fëmijëve, që si rast eksperimental ku mund të verifikohet më qartë statistiki në rajonin e Tetovës duke u bazuar në të dhënat ditore të parametrave të ndryshme ndotës të ajrit gjatë periudhave kur ndotja kulminonte, për shkak të funksionimit të fabrikës Jugohrom dhe pas ndërprerjes me punë të kësaj fabrike.

Andaj, besojmë që ndotja e ajrit mund të jetë e ndërlydhur ngushtë edhe me vdekshmërinë e foshnjeve në Maqedoni, duke patur zanafillën në ndikimin që ka në shëndetin e nënave para dhe përgjatë shtatzënisë.

Vdekshmëria e foshnjave në Maqedoni duhet të jetë e ndërlydhur edhe me shumë faktorë të tjerë, duke filluar nga standardi i ulët, shëndetësi të dobësuar dhe jo profesionale, trajtim jo adekuat dhe kushte jo të favorshme neonatologjike nëpër repartet e gjinekologjisë, ndotja e ambientit, veçanërisht ndikimi në produktet bujqësore, gjegjësisht ushqimore, etj.", thotë Narta Kasa nga Lëvizja Nëna dhe Fëmija, për gazetën "Koha".

KRONIKË

Konfiskohen cigare në Shipkovicë

Tetovë, 12 prill - Pjesëtarë të Policisë së Tetovës në bashkëveprim me pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme nga Shkupi, pasditen e së mërkurës kanë kryer kontroll në shtëpinë e 58 vjeçarit Sh.M nga fshati Shipkovicë. Gjatë kontrollit të realizuar me urdhër të gjykatës, në katin përdehse janë marrë 653 paketime me cigare për të cilët nuk ka patur asnjë dokument për të cilët ekzistojnë dyshime se e kanë prejardhjen nga një vjedhje e mëhershme. Pronari i shtëpisë Sh.M është arrestuar dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Veturën e vjedhur e gjen në qytet

Tetovë, 12 prill - 43 vjeçari me iniciale N.D nga Gostivari, ka denoncuar se të mërkurën pasdite persona të panjohur i kanë marrë veturën Seat Ibiza me targa të Gostivarit e cila ka qenë e parkuar dhe e pambyllur para shtëpisë së tij. Diku në orët e mbrëmjes vetura është gjetur në një rrugë tjetër në Gostivar me ç'rast është arrestuar një 34 vjeçar me iniciale N.I nga fshati Debresh, për shkak të dyshimeve se ka marrë pjesë në vjedhjen e veturës. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Aksident në Zhelinë, dëmtohet muri mbrojtës

Tetovë, 12 prill - Të mërkurën në autostradën Tetovë-Shkup, në afërsi të Zhelinës, veturë e tipit BMW me targa të Tetovës, e drejtuar nga 21 vjeçari B.R nga fshati Strimnicë, ka humbur kontrollin dhe ka dalur nga rruga duke goditur një murr prej betony rreth 30 metra, shtatë shtylla dhe një shenjë komunikacioni. Me veturë të ndihmës së shpejtë është dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës ku edhe i është dhënë ndihmë mjekësore drejtuesit të veturës. Policia njofton se shkak për këtë aksident ka qenë shpejtësia e madhe e papërshtatshme me kushtet në rrugë.

Podgoricë, konfiskohen rreth 100 kg. kanabis

Policia malazeze dhe shqiptare mbrëmë kanë kryer aksion të përbashkët të koordinuar, i cili rezultoi me gjetjen dhe konfiskimin e rreth 100 kilogramëve kanabis në territor të Malit të Zi dhe privimin nga liria të disa personave, për të cilët ekziston dyshim se kanë marrë pjesë në fshehjen e kanabisit nga Shqipëria në Mal të Zi, informon MIA. Me kërkimin në terren, në rajonin Bozhaj në rrugën magjistrale, policia ka gjetur në një shkurre të fshehura thasë të zinë, të mbështjellë me celofan të tejdukshme PVC në të cilin është gjendur material për të cilin ekziston dyshim se bëhet fjalë për mariuhanë të tipit skank. Në afërsi të vendit, në bregun e Liqenit të Shkodrës, policia ka gjetur një varkë, e cila sipas të gjitha gjasave është përdorur për bartjen e kanabisit përmes liqenit nga Shqipëria në Mal të Zi.

Në bazë të këtyre të dhënave, policia nga Shqipëria ka privuar nga liria disa persona, për të cilët supozohet se kanë qenë të përfshirë në veprën penale.

VDEKSHMËRIA MË E MADHE NË KOMUNAT E SHKUPIT

Bazuar në entin statistikor që nga viti 2013 deri në vitin 2016 vdekshmëria më të lartë kanë gjithsesi Qyteti i Shkupit, Tetova, komuna Qendër e Shkupit, Studeniçani, Çairi, Manastiri, Kumanova etj, që flet qartë se këto komuna ishin gjithashtu ndër më të ndoturat në vitet e fundit dhe mund të thuhet që ndotja ka pasur ndikim të konsiderueshëm në këtë koeficient të lartë. Tetova në vitin 2013 ka pasur gjithsej 15 foshnjë të vdekura, ndërsa në vitin 2016 numri i tyre është rritur në 24 dhe aq më keq të gjitha kanë pasur trajtim mjekësor. Andaj duhet të ndërmerren masat urgjente për

ndikim në uljen e këtij koeficienti sa më tepër, gjë që Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë duhet të fillojë program të veçantë, veçanërisht duke filluar në rritjen e standardit të spitaleve dhe qendrave klinike të ndryshme në Maqedoni si dhe përmirësimin e standardit jetësor, programeve speciale për edukimin e nënave të reja përgjatë shtatzënisë dhe pas lindjes, veçanërisht me perkujdesjen direkte të foshnjave nga personeli mjekësor në kuadër të repartit neonatologjik që nuk funksionon shumë ose pothuaj aspak në tërë Maqedoninë, etj.

BIÇIKLETA PËR HANDIKAPËT

QYTETI I SHKUPIT NDAN 1 MILION DENARË



Pavarësisht faktit se subvencionimi i biçikletave është një trend në rritje sa i përket komunave në qytetin e Shkupit, kushtet infrastrukturor sidomos në vendbanimet shqiptare dhe kultura urbane për përdorimin e këtyre mjeteve transportues, ende mbeten të pazhvilluara pazhvilluara



përsëritet.

“Sinqersisht për herë të parë po dëgjoj se do të subvencionohen biçikletat elektronike. Sidoqoftë kjo paraqet një vendim i duhur dhe mjaftë i nevojshëm për anëtarësinë tonë e cila gjithsesi se do ta shqyrtojë mundësinë për të arritur deri te këto subvencione. Në mesin e 500 anëtarëve sa numëron shoqata ‘Shpresa’, mbi 50 prej tyre kanë nevojë për furnizim me këto pajisje (biçikleta elektronike)”, tha Hiseni. Paralelisht me subvencionimin e biçikletave elektronike, kryetari i shoqatës “Shpresa”, Sefer Hiseni, i apeloj administratës së re të Qytetit të Shkupit, t’i nivelizoj qoshet e trotuareve, gjegjësisht përshtatjen e tyre deri në pikën zero (ndonëse shumica e trotuareve janë rregulluar) me të vetmin qëllim që personat me aftësi të kufizuar mos të hasin në vështirësi gjatë qarkullimit të përditshëm.

Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 12 prill- Përveç subvencionimit për blerjen e biçikletave, Qyteti i Shkupit për këtë vit ka ndarë mjete edhe për subvencionimin e blerjes së pajisjeve për udhëtim të personave me aftësi të kufizuar. Shumë e plotë të cilën Këshilli i Qytetit të Shkupit e miratoi të mërkurën kap vlerën e 10 milionë denarëve, prej të cilëve 9 milionë denarë për biçikleta dhe 1 milionë denarë për subvencionimin e pajisjeve (biçikletave elektroni) të specializuar të cilët personat me aftë-

si të kufizuar i shfrytëzojnë për nevojat e tyre të përditshme.

Për gazetën KOHA, nga Qyteti i Shkupit, njoftojnë se shpallja zyrtare për këto subvencione do të bëhet ditëve në vazhdim.

“Për herë të parë administrata e Qytetit të Shkupit, krahas subvencionimit të blerjes së biçikletave, ajo ka ndarë mjete edhe për subvencionimin e biçikletave elektronik, pajisje këto të cilat i përdorin kryesisht personat me aftësi të kufizuar. Personat të cilët do të konkurrojnë për të dy kategoritë (biçikleta dhe biçikleta elektro-

nike) duhet ta kenë parasysh se gjatë parashtrimit të kërkesës për subvencion ato duhet të dorëzojnë llogari fiskale nga blerja e pajisjeve në fjalë konform datës së shpalljes së thirrjes publike dhe përparësi në këtë rast do të kenë të gjithë ata persona që do të paraqiten të parët”, thonë nga Qyteti i Shkupit për gazetën KOHA.

Për dallim nga vitet e kaluara kur Qyteti i Shkupi, për një biçiklete jepte 4 mijë denarë subvencion, kësaj radhe kjo shumë do të arrijë maksimum deri 3 mijë denarë. Ndërkohë, subvencionimi i biçik-

letave elektronike të cilin për herë të parë e praktikon administrata e Qytetit të Shkupit, do të kapë 50 për qind të vlerës së pajisjes në fjalë, ose siç njoftojnë nga kjo njësi e vetëqeverisjes lokale, jo më tepër se 90 mijë denarë për një person me aftësi të kufizuara.

Kryetari i Shoqatës së personave me aftësi të kufizuara “Shpresa”, Sefer Hiseni, lidhur me këtë vendim të Këshillit të Qytetit të Shkupit, tha se nuk është i njoftuar, megjithatë çdo përpjekje për ta ndihmuar këtë kategori të popullatës ai tha se e mirëpret dhe e

Pavarësisht faktit se subvencionimi i biçikletave është një trend në rritje sa i përket komunave në qytetin e Shkupit, kushtet infrastrukturor sidomos në vendbanimet shqiptare dhe kultura urbane për përdorimin e këtyre mjeteve transportues, ende mbetet e pazhvilluar. Uzurpimi i hapësirës publike, konkretisht trotuareve dhe shtigjeve për biçikleta paraqet problemin kryesor me të cilën ballafaqohen shumica e shqiptarëve duke filluar nga Buteli, Shuto Orizarja, Çairi e deri në Saraj.

BRENDA DY MUAJVE ANKESA PËR RASTIN E ALMIRIT

Shkup, 12 prill- Pavarësisht faktit se kanë kaluar tetë ditë nga shpallja e aktgjykimit nga Gjykata e Kumanovës për “rastin e Almir Aliut”, korniza ligjore parasheh që e drejta e ankesave nga palët në këtë proces të mund të parashtrohet pasi të njëjtit të kenë pranuar aktgjykimin. Në këtë drejtim avokati Asmir Alispahiç, shprehet se Gjykata ka të drejtë prej 30 deri në 60 ditë ta shkruaj dhe t’ua dorëzojë atyre aktgjykimin.

“Pasi ta kemi pranuar aktgjykimin, tetë ditë nga ajo datë kemi të drejtë ankesë para Gjykatës së Apelit. Kështu që apeloj për durim për shkak se të këtyra janë procedurat dhe nuk varet asgjë nga ne. Po ashtu e njëjta vlen edhe për përgjegjësinë e prokurores Su-



zana Kusigerska, të cilën do ta denoncojmë deri te Këshilli i Prokurorëve Publike. Mirëpo fillimisht

ne do të presim të shohim se cili është arsyetimi i zgjeruar për shqiptimin e dënimeve të njohura

dhe më pas hap pas hap do të veprojmë, si ndaj prokurores ashtu edhe ndaj personave ekspert”, tha

për gazetën KOHA, avokati Alispahiç

Ndryshe javën e kaluar, pas një procesi gjyqësor kontrovers, me shumë lëshime dhe shkelje procedurale, Gjykata e Kumanovës, e shpalli vendimin skandaloz duke dënuar me vetëm 6 vejt burg vrasësin Boban Iliq (prej të cilëve 21 muajve i ka vuajtur) dhe mbi dy vite burg për familjarët e vogëlushit të ndjerë Almir Aliu. Gjykatësja e lëndës Maja Denkovska, përkundër kërkesave dhe vërejtjeve të shumta nga pala mbrojtëse se ky proces gjyqësor është selektiv, ajo e pranoi rikualifikimin e aktakuzës në rastin e Boban Iliq, dhe të njëjtin e dënoi nën akuzën e kryerjes së veprës penale “aksident me pasoja vdekje”. (O.XH)

Frika nga ndërmarrja e rrezikut dhe mungesa e financave vlerësohen se jenë shkaqet kryesore që të rinjtë në Maqedoni më rëndë vendosin të hapin biznesin e tyre

BIZNESET E REJA ME SHUMË DILEMA

IDETË PA FINANCA, JANË UTOPI

Koha

Fisnik Pasholli

Shkup, 12 prill- Sipërmarrësve në Maqedoni si në nivel qendror ashtu edhe lokal nuk ju mungojnë ide të reja për biznes, por ju mungon përkrahja më e madhe financiare si dhe programet konkrete për të hapur dhe zhvilluar biznese të reja. Si të tilla ato mund të jenë vetëm utopi, asgjë më tepër. Këtë e dëshmojnë, si përvojat e konsulentëve të biznesit, ashtu edhe hulumtimet e organizatave të ndryshme.

Frika nga ndërmarrja e rrezikut dhe mungesa e financave vlerësohen se jenë shkaqet kryesore që të rinjtë në Maqedoni më rëndë vendosin të hapin biznesin e tyre. Dobësitë dhe rreziqet kryesore të sipërmarrjes rinore janë hendeku i madh midis sektorit të biznesit dhe atij të arsimit, sistemi gjyqësor joefikas, qasja e dobët ndaj financave, apatia e përgjithshme të rinjtë për gjendjen në shtet, ikja e të rinjve në tregun e punës jashtë shtetit, mosbesimi ndaj sistemit, korrupsioni dhe administrata akoma e ngadalshme.

Sipas hulumtimit "Sfidat dhe nevojat e sipërmarrësve të rinj në Maqedoni", të përgatitur nga Rrjeti për përkrahje e sipërmarrësve të rinj, në shtet nuk mungojnë masa pozitive dhe reforma për përkrahjen e sipërmarrjes dhe zhvillimin e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, por megjithatë ato janë të pamjaftueshme dhe nevojitet të ndërmerren edhe më shumë hapa të tjera në shtytjen më të madhe të rinjve që të merren me sipërmarrësi.

Në ndërkohë, konsulentët e biznesit me përvojë të gjatë, thonë se si komunat ashtu edhe shteti nevojitet më shumë të angazhohen në favor të hapjes së bizneseve të reja.



"Në nivel të shtetit nuk mungojnë ide të reja për hapjen e bizneseve, ndërsa nuk kemi programe të mjaftueshme për sipërmarrësi si në aspektin e financave ashtu edhe të resurseve për përkrahje të sipërmarrjes. Bile në nivel qendror edhe ekzistojnë programe të caktuara, megjithatë ato në nivelin lokal ekzistojnë vetëm në nivel simbolik. Komunat në Maqedoni prej vitit 2004 e këndeje janë përgjegjëse për zhvillim lokal, mirëpo me përjashtim të qytetit të Shkupit ku ekziston planifikim, ndahen mjete të caktuara si dhe

projektohet buxhet për përkrahje të sipërmarrjes, në tërë Maqedoninë gati aspak nuk kemi përkrahje më të madhe për sipërmarrjen", Nebi Jusufi, konsulent biznesi.

Në ndërkohë edhe programet e ndryshme të USAID në bashkëpunim me institucionet e ndryshme qeveritare angazhohen në përkrahje të biznesit.

"Në bashkëpunim me USAID dhe organizata të tjera punojmë në tejkalimin e hendekut midis nevojave reale financiare të kompanive të vogla dhe të mesme dhe

mundësive që i ofron plani qeveritar për rritje ekonomike. Në këtë drejtim do të bashkëpunohet me rrjetin e lehtësuesve përmes angazhimit aktive të tyre, duke siguruar përkrahje për aplikimet e firmave për shfrytëzimin e fondit në vlerë prej 10.5 milion euro", thotë Jovan Despotovski drejtor i Fondit për Inovacione.

Sipas tij, për çdo ditë nga 10 deri 15 kompanitë interesohen për shfrytëzimin e këtyre mjeteve nga veprimtari të ndryshme në fushën e inovacionit teknologjia informatike, bujqësi, shëndetësi, energje-

tikë, prodhimtari etj.

Edhe nga USAID, që vite me radhë në mënyra të ndryshme përkrah biznesin vendor përmes konsulencave të ndryshme thonë se angazhohen që tu lehtësohet qasja e firmave ndaj financimit përmes angazhimit të më shumë se 30 lehtësuesve. Lehtësuesit përmes ekspertizës profesionale do të mbështesin biznesin që maksimalisht të shfrytëzojë mjetet që shteti i ofron për përkrahje të sektorit privat." Qëllimi i projektit është tu ndihmohet firmave në përgatitjen e biznes planeve me qëllim që sektori privat të shfrytëzojë edhe mënyrat e tjera të financimit përveç shërbimeve të bankave, thotë Biljana Makedonska, drejtore e Projektit për zhvillimin e Sistemit Eko Afarist.

Ndryshe, projekti synon krijimin e vendeve të reja të punës, përmirësimin e shërbimeve afariste dhe qasjen ndaj financave, stimulimin e zhvillimit ekonomik lokal etj.

NË NIVEL LOKAL IDETË JANË SIMBOLIKE

"Në nivel të shtetit nuk mungojnë ide të reja për hapjen e bizneseve, ndërsa nuk kemi programe të mjaftueshme për sipërmarrësi si në aspektin e financave ashtu edhe të resurseve për përkrahje të sipërmarrjes. Bile në nivel qendror edhe ekzistojnë programe të caktuara, megjithatë ato në nivelin lokal ekzistojnë vetëm në nivel simbolik. Komunat

në Maqedoni prej vitit 2004 e këndeje janë përgjegjëse për zhvillim lokal, mirëpo me përjashtim të qytetit të Shkupit ku ekziston planifikim, ndahen mjete të caktuara si dhe projektohet buxhet për përkrahje të sipërmarrjes, në tërë Maqedoninë gati aspak nuk kemi përkrahje më të madhe për sipërmarrjen", Nebi Jusufi konsulent biznesi.

NË KALANË E SHKUPIT, 100 DENARË ORA E PARË E PARKIMIT

Shkup, 12 prill-Ora e parë e parkimit në Kalanë e Shkupit dhe Vodnon e Mesme, do të kushtojë 100 denarë. Çdo orë tjetër pas orës së parë, sipas vendimit të fundit të Këshillit të Qytetit të Shkupit, pritet të kushtojë 50 denarë. Këto çmime të reja që pritet t'i përfshijë edhe disa parkingje në Komunën Qendër, janë kundërshtuar ashpër nga grupi i këshilltarëve të VMRO-DPMNE-së në seancën e fundit të Këshillit



të Qytetit të Shkupit, të cilët theksuan se me këtë vendim në masë

të madhe diskriminohen personat e varfër, të cilët nuk kanë

mundësi të paguajnë një 100 për një orë.

Planifikohet që Zona "AO", ta përfshijë edhe hyrjen dhe hapësirën përreth Kalasë së Shkupit, e cila viteve të fundit është shndërruar në një kaos të vërtet komunikacioni.

Parkimi i autobusëve turistik, shkelja e gjelbërimit dhe parkimi i veturave vend e pa vend, me çmimoren e re të Ndërmarrjes Publike "Parkingjet", për parkimin zonal në "AO", pritet të marrë fund.



Banka Botërore në raportin e saj të pranverës për vendet e Ballkanit Perëndimor i ka kushtuar një vëmendje të veçantë një zhvillimi specific të lidhur me Shqipërinë. Bëhet fjalë për deeuroizimin një masë e deklaruar nga Banka e Shqipërisë gjatë këtij viti

Bankierët milionerë në rritje në Evropë



Financuesit në Evropë që po fitojnë më shumë se 1 milion euro u rritën me një të tretën, në gjashtë vitet e fundit, duke arritur deri në 4,597, përfshirë këtu bankierët e investimeve, të cilët dominojnë në Londër

Një studim i Autoritetit Bankar Evropian tregoi se si paga është rikthyer më rritje në banka, ndërsa rikujtojmë se rrëzimi i tij spektakolar dhjetë vjet më parë shkaktoi dëme shtetërore dhe që nga ajo kohë ka ulur rentabilitetin.

Ndërkohë që shumica e të ardhurave të larta të Europës përbëjnë nga 1 deri në 2 milionë euro në 2016, hulumtimi i EBA zbuloi se mbi 500 ishin paguar më shumë se këto shifra, ndërsa rreth një duzinë morën të paktën 13 milionë euro secili.

Një ekzekutiv në menaxhimin e asetëve kryesonte tabelën, duke fituar një bonus prej 30 milionë eurosh, duke marrë paga totale në shtëpi prej më shumë se 33 milionë euro.

Pagesat janë nganjëherë në kurriz të aksionerëve në bankat e Evropës, tha EBA, duke treguar kështu dividendët e ulët, shkruan Bloomberg.

Megjithëse studimi i EBA-së konstatoi se numri i paketave të pagesave prej miliona eurosh-plus ra midis 2015 dhe 2016, kjo ishte kryesisht si rezultat i rënies së vlerës pas votimit të Britanisë për t'u larguar nga Bashkimi Evropian në qershor 2016.

Për shkak se shumica e të punësuarve të mëdhenj janë të vendosur në Londër, kjo i shtynte të dhënat kur u hartua në euro, por në afat të gjatë, numri i të punësuarve të lartë u rrit nga më pak se 3,500 në vitin 2010 në 4,597 në vitin 2016, tha EBA.

Më shumë se gjysma e miliona euro-plus një vit përfitohen nga bankierë investimesh sipas EBA, ndërsa një numër më i vogël bien në kategori të tilla si menaxhimi apo bankat.

DE-EUROIZIMI, JA MASAT QË DUHET TË MERRREN

Por çfarë nënvizon në fakt raporti i BB? Së pari ky institucion shpjegon arsyet se pse euroizimi i sektorit financiar pati një nivel të lartë duke e lidhur këtë me fazën e tranzicionit por edhe me faktin që agjentët e tregut u fokusuan tek përfitimi përmes diferencave të normave të interesit në transaksione me monedha të ndryshme. Pra huadhënie në monedhë të huaj dhe ofrimi i interesave më të leverdishme për depozitat në monedhën vendase. Së dyti, Banka vlerëson se Shqipëria nuk është i vetmi vend me një nismë si kjo, Serbia e Maqedonia e kanë marrë këtë iniciativë më herët. Së treti Banka nënvizon masat që duhet të kihet parasysh kur ndërmerret një politikë e tillë.

“Që nga fillimi i tranzicionit që u shoqërua me një inflacion të lartë dhe mungesë stabiliteti makroekonomik dhe politikë mosbesimi tek monedhat vendase rezultoi me një euroizim të depozitave. Dhe ndërkohë që agjentët ekonomikë shfrytëzuan diferencat e normave të in-

teretit mes kredive në monedhë të huaj dhe depozitave në monedhën vendase u zhvillua edhe euroizimi i asaj që njihet si carry tade apo transaksione me monedha për të përfitur nga diferenca e normave të interesit.

Në Ballkanin Perëndimor, euroizimi i depozitave ishte dominant; kreditë në euro dhe depozitat aktualisht përbëjnë 70 për qind të totalit në Serbi dhe 60 për qind në Maqedoni. Në Shqipëri, fenomeni që lidhet me përfitimin nga diferenca e normave të interesit u reflektua me një situatë të tillë ku 70 për qind e kredive ishin në euro, kurse depozita vetëm 40 për qind. Në Shqipëri, historikisht interesi për depozitat në monedhë vendase ka qenë i lartë, kështu që familjet dhe korporatat kanë kursyer në monedhën vendase por kanë marrë hua në modhena të huaja relativisht më pak të kushtueshme.

Shqetësimet për transmetimin e kufizuar të politikës së normës së interesit dhe mospërputhjet në bilancet që rri-

sin risqet markoekonomike kanë çuar disa vende të Ballkanit Perëndimor që të kërkojnë në mënyrë aktive atë që njihet si de-euroizim. Por kthimi përmbys i kësaj situatë ka rezultuar i vështirë. Në kushtet e ndërgjegjësimit për riskun e normës së këmbimit dhe mjetetve makroprudenciale për uljen e incentivave të huadhënies në monedhë të huaj kreditimi në monedhën e huaj ra në mënyrë graduale e ndihmuar edhe nga fshirja e kredive të këqija ku 75 për qind ishin në monedhë të huaj. Ashtu si në vende të tjera në kushte të ngjashme deurozimi në depozita ka qenë më i ngadaltë sesa në kredi (historikisht eurozimi i depozitave është zgjidhur siç duhej vetëm kur vendet në tranzicion i janë bashkuar zonës euro) në fakt në Shqipëri pjesa e depozitave në monedhë të huaj është rritur nga 44.1 për qind në 2009 në 53.1 në 2017 dhe në Serbi dhe Maqedoni është tkurrur me 11.4 pikë përqindje dhe 17.9 pikë përqindje krhasuar me nivelin më të lartë të tyre. (MONITOR)

Çeliku i Maqedonisë rrezikohet nga masat e BE-së

Masat mbrojtëse që ka shpallur BE-ja paraqiten si një reflektim i kufizimeve të zbatuara më parë nga SHBA për importin e produkteve të çelikut

Shoqata e Metalurgjisë pranë Odës Ekonomike të Maqedonisë ka kërkuar që Maqedonia të distancohet nga masat e SHBA-së dhe Bashkimit Evropian (BE) për importin e kufizuar të produkteve të çelikut, sepse sipas këtij trupi tregtar, distancimi i vendit nuk paraqet kërcënim për tregjet e tyre dhe as që mund t'i rrezikojë në ndonjë mënyrë ato, raporton Anadolu Agency (AA).

Sipas kreut të Shoqatës së Metalurgjisë, Mitko Koçovski, masat mbrojtëse që ka shpallur BE-ja, edhe pse siç thotë ai, duken të papajtueshme, paraqiten si një reflektim i kufizimeve të zbatuara



më parë nga SHBA për importin e produkteve të çelikut.

Koçovski i bëri thirrje diplomacisë maqedonase ekonomike që në maksimum të angazhohen në këtë drejtim dhe të tregojnë pasojat e këtyre masave pas zhvillimit të ekonomisë kombëtare ma-

qedonase.

“Eksportet e produkteve të çelikut maqedonas janë 256 mijë tonë, ose vetëm 0,87 për qind e totalit të importeve në BE. Përsëri, i njëjti përfundim se në asnjë mënyrë eksporti i produkteve maqedonase të çelikut në Union nuk

paraqet faktor për destabilizimin e tregut të tyre. Me një argument të fortë se eksporti i produkteve të çelikut nga Maqedonia bëhet me çmimet normale të tregut dhe në asnjë mënyrë nuk shkelin parimet e tregut normal”, deklaroi Koçovski.

Sipas tij, të dy masat paraqesin kërcënim serioz për metalurgjinë si degë industriale me ndikim të madh ndaj ekonomisë maqedonase, të shprehura përmes efekteve të drejtpërdrejta dhe të shumëfishta që i ka ndaj ekonomisë së tërë kombëtare.

Koçovski vuri në dukje se, përveç mbrojtjes nga importi i disa produkteve të çelikut, një goditje shtesë është edhe masa e BE-së për eksportin e kufizuar të hekurit.

Rreth 3.000 persona punojnë në industrinë e çelikut maqedonas, por në mënyrë indirekte nga masat e SHBA-së dhe BE-së do të preken 15 mijë persona të angazhuar në aktivitete të lidhura.

Siç tha Koçovski, viti filloi shumë më mirë, tregu u ringjall dhe çmimet ishin të mira, por tani industria përballlet me një nga sfidat më të mëdha që mund të jenë fatale për ekonominë e Maqedonisë.

Autori përmes kësaj vepre tregon se largimi i paragjykimeve është e ngjashme me një luftë kundër mullinjve me erë. Në role luajtën aktorët: Teuta Ajdini Jegeni, Dritëro Ame, Rabije Alilovska dhe Besfort Idrizi, me regji të Blerta Neziraj, skenografi të Enes Deari dhe kostumografi të Roza Trajçevska Ristevska.



VJEN PREMIERA E SHFAQJES “MULLINJTË E ERËS” NË SHKUP


Në Teatrin e Fëmijëve në Shkup të martën u shfaq drama për fëmijë “Mullinjtë e erës”, e autorit Jeton Neziraj. Ngjarja zhvillohet me katër personazhe, ku njëri prej tyre Miler (Müller) shndërrohet disa herë në një gjigand (Muja), ku ka fuqinë të lëshoj frymën e të lëviz gjithçka përreth. Miler ka marrë përsipër të realizojë projektin e tij, për ngritjen e turbinave, për prodhimin e energjisë elektrike me fuqinë e erës në Kosovë. Sipas tij projekti do të zgjas dy vite dhe për këtë ai detyrohet të merr me vete familjen, gruan dhe vajzën adoleshente. Mirëpo, grua ja dhe vajza do të trishtohen nga ky lajm, sepse nëpërmjet mediave, Kosovën e njohin me shumë probleme dhe ngjarje të jashtëzakonshme dhe

ky vendim i kryefamiljarit nuk është i përfillshëm.

Por më në fund ai do ti bind dhe ata shkojnë në Kosovë. Në fillim mbetën të cinguar dhe jetonin në një ambient të izoluar, ku ishin edhe disa diplomatë, gazetarë të huaj. Përtej dritareve të kësaj “strofulle” dëgjohej të shtëna armësh, që vinin nga dasmorët, sepse ashtu e ka traditë kombi shqiptar, që dasmat ti bëjnë me armë zjarri. Familja do të përshtatet menjëherë në shtetin e Kosovës, aq më shumë vajza Gisela, e cila do të njuh mo-shatarët e tij. Dani ishte shoku që u shoqërua. Ky djalë veçohet për sytë e larmë dhe ushqimin e tij të preferuar “çipsi”. Ata të dy mirëkuptoheshin dhe preferonin të tregonin jetën e njëri tjetrit. I rrëfenin përrallat “Bukuroshja e fjetur”,

“Macja dhe qeni” dhe të ngjashme. Dani i flet asaj për aventurat interesante të Mujës, një heroi të njohur të Ballkanit. Një hero i tillë mund të ndihmonte në punën e babait të Giselës, të cilit duket se nuk i shkon aq mirë puna me projektin e tij të turbinave me erë. Dhe kjo dëshirë e Giselës u realizua, në momentin më kritik, ku Miler do të hiqte dorë dhe të kthehej në Gjermani.

Autori përmes kësaj vepre tregon se largimi i paragjykimeve është e ngjashme me një luftë kundër mullinjve me erë. Në role luajtën aktorët: Teuta Ajdini Jegeni, Dritëro Ame, Rabije Alilovska dhe Besfort Idrizi, me regji Blerta Neziraj, skenografi Enes Deari dhe kostumografi Roza Trajçevska Ristevska. *D.Kërluku*



“DUSHKAJA”, romani më i ri i Jusuf Buxhovit

Pas romaneve “Dosja e hapur” dhe “Dosja B”, të cilat merren me dukuritë dhe ngjarjet politike në Kosovën e pasluftës, Jusuf Buxhovi po të njëjtin preokupim e vazhdon edhe në romanin më të ri “Dushkaja”. Kritiku letrar, Ramadan Musliu, vlerëson se romani më i ri, i autorit Buxhovi, që doli këto ditë nga shtypi, për dallim nga dy romanet e përmendura, bën një qasje ndryshe te realitetit, përvojave të hidhura, gjendjeve iracionale, krimin të luftës sa dhe pasojave të tij, në të vërtetë bën një autopsi të brendshme të këtyre përvojave, duke e vënë krimin në një rrafsh refleksioni. E gjithë drama e realitetit, ku krimi bëhet alfa dhe omega e jetës në një hapësirë çfarë është Dushkaja, gjen pasqyrimin në ndër-dijen e piktorit, cili përmes një dialogimi më zërin, alteregon e tij, shpalos fatin e njeriut në zgrip të ekzistencës, të cilit i mungon e tashmja po se po, por e më shumë se e tashmja atij i mungon e ardhmja. Musliu thotë se forma eseizuese e rrëfimit kushtëzon gjithsesi edhe formën e receptimit sa që mund të thuhet se është një tekst për një lexues të kultivuar.

“Mollkuqet” e Gjilanit, përfaqësim dinjitoz në Bjellorusi

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot në takim përfaqësuesen e qendrës kulturore “Mollkuqet”, Arta Haziri Nuhiu, e cila së bashku me katër talentet na Gjilani, Edisa Ahmeti, Ilda Nuhiu, Valenta Selimi dhe Yllka Dema, do të nisen për në Minsk të Bjellorusisë për ta përfaqësuar Kosovën në festivalin ndërkombëtar të muzikës “Lemari”.

Kryetari Haziri, pasi u ka uruar suksese në këtë festival, ka thënë se ky është shembulli më i mirë i talentëve që ka Gjilani në këtë dhe disa fusha tjera.

“Unë ju uroj shumë suksese dhe shpresoj shumë që do ta në bëni krenarë të gjithëve me rezultatet e arritura. Mbështetjen e Komunës do ta keni në vazhdimësi”, ka thënë Haziri, transmeton Insajderi.

Ndërkaq, drejtoresha e qendrës kulturore “Mollkuqet”, Arta Haziri Nuhiu, e ka



falënderuar kryetarin Haziri për pritjen dhe mbështetjen e madhe që i ka dhënë festivalit “Mollkuqet”. “Do ta bëjmë të pamundurën që ta përfaqësojmë shtetin tonë në mënyrë sa më dinjitetshme dhe të rithehemi me trofe të fituar nga ky event i madh ndërkombëtar, ku Kosova për herë të parë

po merr pjesë. Më 17 prill do të jetë nata finale dhe besojmë që do ta bëjmë krenar vendin tonë”, ka thënë Haziri Nuhiu.

Në këtë takim, suksese i kanë uruar talentëve të Gjilanit edhe kryesuesja Shpresa Kurteshi Emini dhe drejtoresha e Arsimit, Majlinda Hoxha.

Filmi “Everybody Knows” hap Festivalin e Kanës

Filmi “Everybody Knows” në gjuhën spanjolle me yllin e Hollywoodit, Penelope Cruz, do të hap festivalin e filmit në Kanë këtë vit. Trileri psikologjik do të jetë filmi i parë që nga viti 2004 që do të hap festivalin prestigjioz të filmit, e që nuk është xhiruar në anglisht ose frëngjisht. Organizatorët e festivalit të enjten njoftuan se festivalin do të hap filmi i regjisorit iranian Asghar Farhadi, i cili zgjat nga 8 deri më 19 maj. Filmi flet për intrigat familjare dhe dilemat morale të një gruaje, jeta e së cilës kthehet me kokën poshtë kur ajo largohet nga Argjentina dhe vjen në Spanjë. Krahas Cruz, në këtë film luan edhe ylli spanjoll Javier Bardem dhe aktori argjentinas Ricardo Darin. Farhadi është fitues i çmimit Oscar “A Separation” dhe “The Salesman” në kategorinë e filmave jo-anglishtfolës. Juria e festivalit kryesohet nga aktorja Cate Blanchett.



AGNUS DEI – triumfon në San Antonio të Ekuadorit

Në festivalin San Antonio Independent Film Festival i cili ka përfunduar në San Antonio de Ibarra të Ekuador-it, filmi kosovar AGNUS DEI me skenar dhe regji të Agim Sopit, ka fituar çmimin e Filmit më të mirë /Best Feature Film/, transmeton Koha.net. Më shumë se 700 tituj filmash nga 77 vende të botës kanë defiluar në nëntë kategori të ndryshme në eventin e shtetit jugamerikan, duke ‘krijuar një pasqyrë të mprehtë të rrjedhave botërore kinematografike’ thuhet në një kumtesë të festivalit. Filmi kosovar, është cilësuar si një ‘realitet onirik i botës së errët në të cilën po zhytet civilizimi ynë padiktueshëm, një jehonë e ndërjegjjes së thellë të targjedisë së individit që merr dimensione nga të dyja anët e frontit për të krijuar një vepër të fuqishme unike, një dorëshkrim autorial tepër të rrall dhe shumë poetik’ (nga arsyetimi i jurisë profesionale). Filmi Agnus Dei, zë fill në tragjedinë e antikitetit mbi fatin e Edipit, fëmiut të braktisur nga babai i cili duke ikur nga tragjedia e parashikuar, kthehet pikërisht në shtëpinë e babait biologjik për ta vrarë atë. Edipi, i penduar i nxjerr vetes sytë, për të mos e parë më dritën e diellit, duke rezytuar jetën e vet tragjike në formë amaneti: ‘O dritë e diellit, qoftë hera e fundit që po të shoh, sepse unë linda nga ata që s’duhej, rrojta bashkë me ata që s’duhej dhe vrava atë që s’duhej’.

RRUGËT TONA NË UDHËKRYQIN ETNIK

Shkruan:
Mr. Delvina KËRLUKU



Edhe njeriu me “dy ditë shkollë” e ka të qartë se njëri ndër faktorët kyç për zhvillimin e një vendi është infrastruktura rrugore, përveç asaj hekurudhore, ujore e ajrore. Prandaj, gati të gjitha qeveritë konstruktive, pjesën më të madhe të investimeve kapitale, i orientojnë tek infrastruktura. Bile, qeveri vizionare, të disa shteteve, shtrojnë linja hekurudhore nëpër territore të cilat planet urbanistike i hartojnë dhe jetësojnë shumë më vonë. Por tek strategjia e zhvillimit infrastrukturor, ka dhe një tjetër, shumë të rëndësishme – atë të shpërndarjes harmonike në mbarë territorin e shtetit, madje me përparësi të theksuar për viset e pazhvilluara, ose më pak të zhvilluara. Këto modele të infrastrukturës hartohen dhe zbatohen me përpikëri, pasi qeveria është e përgjegjshme dhe e ndërgjegjshme se kjo politikë sjell zhvillim të hovshëm dhe të qëndrueshëm, por nuk shkakton as shqetësime sociale dhe etnike.

Por ç'ndodh në Rastin e Maqedonisë (po deshët edhe të ish Jugosllavisë)? Këtu, qeveritë e djeshme, edhe të sotme, komponentës së shpërndarjes harmonike të buxhetit të paraparë për ndërtimin e rrugëve dhe hekurudhave, i ikën si shejtani temjanit. Bile bëjnë njëqind e një hile, vetëm e vetëm pjesët më pak të zhvilluara të mos zhvillohet dhe sidomos ndër viset ku banojnë shqiptarët të mos shtrohet asnjë metër asfalti dhe të mos shtrihet asnjë metër hekurudhe. Çudit fakti që me këtë politikë diskriminuese, pajtohen gjithmonë pjesëmarrësit (shpesh herë kukulla) shqiptarë. Edhe naivi më i madh këtë e sheh si dritën e diellit.

Për ta pasur lexuesi pak më të qartë këtë politikë të mbrapshtë, po japim vetëm disa shembuj. Korridori dhjetë, bie fjala, i cili lidh Beogradin me Athinën, edhe pse është mjaft i gjatë dhe i kushtueshëm, është në përfundim e sipër, kurse korridori tetë që lidh Tiranën (Durrësin) me Shkupin, nuk i është shtuar asnjë centimetër. Deri tani janë ndërtuar vetëm 35 km (Tetovë - Shkup). Rruga Kërçovë - Ohër (lexuesit nuk e kanë harruar reklamën false me emërtimin e parë: Kërçovë - Strugë - Qafë Thanë, sa për tu hedhur hi syve shqiptarëve të mjerë, është një tallje me qytetarët. Për tre vjet nuk është



ndërtuar asnjë metër. Kudo gjatë trasesë syri të sheh vetëm grumbuj dherash. Shqiptari ka sy dhe e sheh hilenë. Ai pyet: përse u bë kjo kontratë me kinezët e jo me të tjerët; përse me kinezët qeveria u mor vesh për rrugën Milladinovci - Shtip, e për këtë s'u marrka vesh. Pse ju dha përparësi asaj rruge (gojë e liga flasin se i duhet Zaevit për të shkuar më rehat në Strumicën e tij). Jo vetëm kaq: përse në pjesën Lindore dhe Qendrore të Maqedonisë ndërtohen rrugë të

shpejta dhe paralele, siç është rasti i rrugës Shtip - Radovish, Rankovcë - Kriva Pallankë, deri në Deve Bair, Kumanovë - Beljakovce - Kriva Pallankë deri në kufirin me Bullgarinë (hekurudhë), pastaj asaj Veles - Prilep, etj., etj., kurse për rrugët Tetovë - Prizren, Dibër - Strugë, Dibër - Kërçovë, Dibër - Mavrovë - Bllatë, Shkup - Bllacë, Tetovë - Jazhincë, Likovë - Bellanoc etj., pra aty jetojnë shqiptarët, asnjë plan, asnjë fjalë, asnjë zë. Me këtë politikë diskriminuese qeveria jonë, jo

Si fëmijë e dëgjoja shpesh një parullë plot pezëm të shqiptarëve “Trepça punon-Beogradi ndërton!” Kam frikë se kjo parullë pak e ndryshuar të dëgjohet në gojën e shqiptarëve të Maqedonisë: “Shqiptarët kontribuojnë- Maqedonasit ndërtojnë”. Natyrisht jo vetëm rrugë, por edhe zona industriale, fabrika, shkolla, spitale, salla sportive, shtëpi kulture etj..



vetëm që i dëmton shqiptarët, edhe duke i shfrytëzuar kontributet e tyre për t'u ndërtuar super rrugë maqedonasve, por e dëmton edhe zhvillimin ekonomik të mbarë shtetit, meqë nuk ia bën të mundshme daljen më të shpejtë, më të afërt e më të sigurt në portet detare (të Shqipërisë)!!! Pra, në Maqedoni janë ndërtuar rrugë kudo e kahdo, vetëm rrugë që lidhin shqiptarët këtu dhe me shtetet shqiptare, nuk ndërtohen.

Për ata që s'kanë lidhje me gjeografinë dhe demografinë, deklaratat e ministrit Sugarevski, apo kryeministrit, tingëllojnë aq të bukura dhe aq bindëse, sa s'ka. Dhe të tilla janë për një pjesë të qytetarëve, por jo për të gjithë. Në rastin konkret jo për ne shqiptarët. Si fëmijë e dëgjoja shpesh një parullë plot pezëm të shqiptarëve: “Trepça punon-Beogradi ndërton!” Kam frikë se kjo parullë pak e ndryshuar të dëgjohet në gojën e shqiptarëve të Maqedonisë: “Shqiptarët kontribuojnë - Maqedonasit ndërtojnë”. Natyrisht jo vetëm rrugë, por edhe zona industriale, fabrika, shkolla, spitale, salla sportive, shtëpi kulture etj.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 koggio | Data e shtypjes e enjte 12 prill | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

PARA LIGJIT TË GJITHË (NUK) JANË TË BARABARTË

Nga
Rami VELIU

Në të shumtën e rasteve thënia: "PARA LIGJIT TË GJITHË (NUK) JANË TË BARABARTË" me të madhe përdoret në drejtësi, por ja që në praktikë devijon edhe atë shumë. Prandaj, me të drejtë themi se: "Para ligjit të gjithë (nuk) janë barabar"! Kjo vin në shprehje atëherë kur janë në pyetje shqiptarët, ndërkaq kur janë në pyetje maqedonasit, kjo fjalë vin në shprehje të plotë. Për këta çdo gjë është në rregull! Në jurisprudentë dënimet për fajet e bëra caktohen sipas fajit të bërë edhe atë prej një (1) deri me 20 vjet burg ose me burg të përjetshëm. Pra, ka minimumin dhe maksimumin e dënimit. Minimumi është i dedikuar për maqedonasit, ndërkaq maksimumi për shqiptarët dhe etnitetet tjera. Kështu ishte edhe në kohën e ish Jugosllavisë, por edhe tash në Maqedoninë demokratike apo si që thuan në të shumtën e rasteve Maqedoninë multietnike.

Këtu bëhet fjalë për rastin e vrasjes së fëmijut i njohur tashmë si "rasti Almiri" i cili mori dhenë në opinionin e vendit dhe më gjërë. Me të u bë "me zë" edhe drejtësia në Maqedoni së bashku me Bobanin, vrasësi Boban Iliç. Sipas vrasjes së bërë, Bobani është dashur të dënohet me burg prej 4 deri 20 vjet. Porota bëri rikualifikimin e dënimit prej atij vepër penale e rikualifikoi në "fatkeqësi komunikacioni



me pasoj vdekjeje", dhe me këtë gjyqi i apelacionit e dënon Bobanin me 6 vjet burg! Ky gjyq e shpëtoi Bobanin nga maksimumi (20 vjet). Dhe ja, ky ishte epilogu i këtij gjykimi i cili në masë dhe ndër partitë politike shqiptare ngjalli një revolt. Thënë së drejti një dënim i tillë u prit qysh kur i'a ndryshuan aktakuzën. Shihej sheshazi se këkrohej një dënim minimal për vrasësin, pasi bëhet fjalë për një fëmijë shqiptar! Raste të tilla ka shumë në Maqedoni, ku ka edhe gjykime sipas politikës ditore si që ishte rasti i Sopotit ku të pafajshmit dënohen me burg të përjetshëm, apo si vijuesi i Liqenit të Smilkovës si dhe ai i Kumanovës.

Në periudhën turke ekzistonte një proverb e cila është si vijon: "Nasradini shkon te kadiu dhe i thotë se lopa yte e ka vlarë lopën time. Kadiu i përgjigjet se ajo nuk është gjë ata janë kafshë. Nasradini e kupton se këtu ka ndonjë mosmarëveshtje dhe i drejtohet kadiut: z. kadi lopa ime e ka vlarë lopën tënde. E atëherë ndryshon aktakuza, e kthen në anën tjetër dhe e dënon Nasradinin." Pra, edhe kjo ngjarje e ka pasur rastin e njëjtë si ai i Nasradinit, Bobani dënohet për vrasjen e Almiri me 6 vjet burg! Kjo vrasje nuk ishte një vrasje e thjeshtë, kjo ishte një vrasje makabre. Bobani për atë vrasje "verbale" sipas filmit të inicuar në TV, ai prej anës së majtë

kthen veturën kah muri ku qëndron-te Almiri me nënën e tij, ku shihet qartë që Almirin e vogël e shtrydh për muri. Prandaj themi se kjo nuk ishte një vrasje e thjeshtë, por ishte një vrasje makabre, një vrasje me paramendim i bërë nga një kriminel, kur kësaj t'ia shtojmë edhe atë se gjykata u vu në mbrojtje të këtij krimineli, kjo më haptazi tregon se çfarë gjykimi ka qenë. Të vihesh në anën e këtij krimineli, kjo më është më tepër se një krim. Me të drejtë ky gjykim hasi në revoltë tek qytetarët. Numër jo i vogël i tyre protestuan rrugëve të Shkupit dhe para gjykatës, por gjykatësit nuk ndryshuan këtë vendim. Nga ana e mbrojtësit të Bobanit edhe ato pak vite (6 vjet) iu dukën shumë, kërkoi që i akuzuari të lëshohet në liri sepse nuk paska qenë ndonjë krim i Bobanit!

Kjo na tregon se me të vërtetë në Maqedoni është vështirë të jesh shqiptar. Këtu edhe pa asnjë faj mund të dënohesh edhe me burg të përjetshëm. Kur gjithë kësaj t'ia shtojmë edhe atë se ekspertiza u kry nga ekspert pa licencë, atëbotë kuptohet se çfarë gjykimi ka qenë ky rast i Almiri. Kjo është më tepër se një lojë. Kjo na brenos shumë neve shqiptarëve të Maqedonisë, kur mendojmë se çfarë gjykatësish na gjykojnë. Të kërkosh drejtësi te këta gjykatës me të vërtetë është budallallëk!

Në Maqedoni është vështirë të jesh shqiptar. Këtu edhe pa asnjë faj mund të dënohesh edhe me burg të përjetshëm. Kur gjithë kësaj t'ia shtojmë edhe atë se ekspertiza u kry nga ekspert pa licencë, atëbotë kuptohet se çfarë gjykimi ka qenë ky rast i Almiri. Kjo është më tepër se një lojë. Kjo na brenos shumë neve shqiptarëve të Maqedonisë, kur mendojmë se çfarë gjykatësish na gjykojnë. Të kërkosh drejtësi te këta gjykatës me të vërtetë është budallallëk!

Kur gazetari "ul qepenin", për hir të lajmit

Nga

Armando Meta



"U"le qepenin sa të bëj dy plane". Kjo ishte dje mënyra e raportimit të lajmit nga gazetarja televizive, lidhur me protestën e thirrur nga opozita për hyrjen në skemën e TVSH-s edhe të biznesit të vogël. Tek e dëgjon këtë gazetare që për të raportuar për çfarë po ndodhte në terren lidhur me këtë protestë, ndjen keqardhje për standardin në të cilin ka rënë profesioni mjaft domethenës i gazetarisë. Një pjesë e jona kolegësh marrin përsipër të bëjnë regjinë, lëvizjet skenike, madje dhe të udhëzojnë se çfarë duhet të thonë apo të bëjnë personazhet e kronikave të tyre.

Këtu nuk është fjalë për të gjykuar nëse vendimi për të futur në skemën e TVSH-s edhe biznesin e vogël është i drejtë apo i padrejtë. Problemi qëndron në faktin se për

Sajimet e lajmit me regji e koreografi është e vërtetë që tashmë po dominojnë, duke sjellë dëme jo të vogla në profesionin e gazetarisë dhe cilësisë së lajmit. Problemi nuk është se të tilla lajme të sajua janë raste sporadike.



"hir të bukës së përditshme", gazetarët nuk mund të ndërhyjnë në mënyrën se si zhvillohen ngjarjet, se çfarë duhet të thonë personazhet që ata zgjedhin, që për të dhënë

frymën e protestës pavarësisht se një tregtar është në punën e tij i thuhet të "ulë qepenin" etj. Kur merr përsipër të bësh gjëra të tilla nuk ke më asnjë lidhje me profesionin e gazetarisë, por je thjeshtë një militant që të kanë dhënë në dorë një mikrofon dhe një kameraman që rend pas teje për të regjistruar.

Gazetarët e terrenit në të gjithë historinë e këtij profesioni janë dëshmitarë të asaj që ndodh dhe nuk sajojnë thjeshtë që të "fitojnë bukën e përditshme". Janë me qindra raste në botë, por edhe në Shqipëri, që gazetarë të ndryshëm kanë bërë histori duke marrë mbi supë si reagimet negative apo dhe pozitive të opinionit shoqëror, pasi i kanë lënë ngjarjet të zhvillohen në dimanikën e tyre, pa ndërhyrë dhe trukuar ato. Ndërhyrjet në disa raste mund të kishin shpëtuar edhe jetë njerëzish,

etj. Por ata kanë zgjedhur të jenë dëshmitarë dhe jo "regjisorë".

Në momentin kur i thua tjetrit se çfarë duhet të bëjë, që në atë moment profesionalisht je kompromentuar rëndë, pasi në realitet gazetari po transmeton një lajm të sajuar. Përpjekja për t'u dukur kompetentë në të gjitha fushat, i ka bërë jo pak dëm profesionit të gazetarisë, si dhe ka ulur ndjeshëm besueshmërinë ndaj lajmit në përgjithësi. Është e vërtetë e pamohueshme se gazetarët gjithnjë e më pak lexojnë, apo të marrin informacion paraprakisht për temën e konferencës së shtypit që ata thirren për ta pasqyruar. Mjafton të dëgjosh pyetjet që bëjnë për të kuptuar se as që e kanë idenë se për çfarë po diskutohet dhe aq më pak të kenë njohuri për problematikën. Një paraqitje në këto nivele shumë të de-

batueshme bie në sy jo vetëm në komunikimin me politikanët vendas, por edhe ata të huaj të cilët në jo pak raste ngelen 'pa gojë' nga niveli i pyetjes. Ky nivel ka bërë që edhe politikanët përgjithësisht të jenë rehat, pavarësisht mufkave që nxjerrin nga goja, si dhe rëndomtazi të mos marrin mundimin të presin dhe ndonjë pyetje që mund t'u bëhet.

Sajimet e lajmit me regji e koreografi është e vërtetë që tashmë po dominojnë, duke sjellë dëme jo të vogla në profesionin e gazetarisë dhe cilësisë së lajmit. Problemi nuk është se të tilla lajme të sajua janë raste sporadike. Problemi është se kjo lloj 'mode' po gjen gjithnjë e më shumë përhapje, gjë që ka sjellë për pasojë edhe largimin gjithnjë e më të madh të njerëzve nga ekranet kur jepen...lajmet.

Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj, kanë ashpërsuar së fundmi fjalorin ndaj Serbisë. I pari para pak ditësh, tha se 'Serbisë mund t'i përgjigjemi si në të kaluarën, me pushkë kurse i dyti, sot deklaroi se 'çdo ide për shkëmbim terrioresh nënkupton luftë'.

Periskopi ju risjell këto deklarata të Thaçit dhe Haradinajt si dhe deklaratën e këtij të fundit, vetëm një ditë më parë, se 'nuk e ka pranuar dorëheqjen e Listës Serbe nga Qeveria' dhe se 'po bisedon me Listën Serbe që ata të vazhdojnë punën në Qeveri'.

IDEA E SHKËMBIMIT TË TERRITOREVE

Që prej dështimit të zhbërës së Gjykatës Speciale, në media kanë qarkulluar informacionet se dialogu në vazhdim Kosovë – Serbi, mund ta ketë një pikë të nxehtë diskutimi: shkëmbimin e terrioreve mes të dyja vendeve.

Pas festimit të dekadës së shpalljes së pavarësisë, prestigjiozja 'The Economist' në një artikull për Kosovën, pati shkruar se janë sh-

SERBINË E KËRCËNOJNË MË LUFTË E PUSHKË, LISTËS SERBE I BIEN NË GJUNJË



tuar zërat në Beograd për një ndarje të shtetit më të ri në Evropë, Kosovës.

"Serbët kërkojnë të shkëmbejnë zonat e banuara me shqiptarë brenda Serbisë me pjesën veriore të Kosovës. Mbështetësit e kësaj teorie thonë se shtetet multietnike nuk funksionojnë në Ballkan", shkruante artikulli i Economist.

Në Serbi, patën nisur të vlonin kritikën për Vuçiqin, pasi sipas tyre, ai kishte pranuar, madje ishte i gatshëm për opsionin e shkëmbimit të terrioreve me Kosovën.

Megjithëse ishte emri i përfulur se po zhvillon bisedime të fshehta me Vuçiqin, presidenti i

Kosovës, Hashim Thaçi, më vonë, i quan ide të kota mendimet që flasin për shkëmbim terrioresh mes Kosovës dhe Serbisë.

Por, kur mediat raportonin lidhur me këtë çështje, zyra e Presidencës së Kosovës, kishte thënë vetëm se në 'këtë fazë është spekulim një ide e tillë', por që nuk mohonte decidivisht idenë.

PUSHKË E LUFTË ME SERBINË

Derisa mbetet e paqartë ideja se sa mund të jenë të vërtetë zërat e tillë, ndërkohë kryeministri Ramush Haradinaj sot ka thënë se 'çdo ide e tillë nënkupton luftë'.

"Kushdo që i hin kësaj rruge nënkupton luftë, most a çojmë ma

larg", ka thënë Haradinaj, transmeton Periskopi.

Ndërkohë, i 'urit' për luftë, duket edhe presidenti Hashim Thaçi. Në përvjetorin e betejës së Koshares, ai ka thënë se kërcënimeve të Serbisë 'do t'u përgjigjemi si në ta kaluarën, me pushkë'.

"Këtyre kërcënimeve do t'u përgjigjemi siç iu kemi përgjigjur para 19 vitesh, me pushkë", tha Thaçi para pak ditësh në Koshare.

'S'E KAM PRANUAR DORËHEQJEN E LISTËS SERBE...'

Por, përkundër këtyre deklaratave, në anën tjetër, vetëm një ditë më parë, kryeministri Haradinaj ka thënë se ai është duke zhvilluar dialog me Listën Serbe, në mënyrë që ata të qëndrojnë në Qeveri.

Haradinaj ka thënë se nuk e ka pranuar dorëheqjen e Listës Serbe nga Qeveria dhe kjo sipas tij 'nënkupton se mund të zhvillohet ende dialog që ata të jenë pjesë e Qeverisë dhe t'i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë që kanë.

Në këtë mënyrë, kryeministri në një rën anë përdorë fjalor 'luftarak' me Serbinë, kurse në anën tjetër, lut atë që njihet si 'instrumenti i Vuçiqit' në Kosovë, Listën Serbe.



Haradinaj: "Me defilimin e Gjuriqit dolëm keq para Brukselit"

Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj, në 'FOL Hapur', thotë se aksioni i arrestimit të Gjuriqit ishte në rregull ligjrisht sepse Ministria e Brendshme ka zbatuar një urdhër për ndalesë.

"Tash, nëse flisim për çështjen e zotit Gjuriq, baza ligjore është në rregull, ka pasë një ndalesë në hyrje dhe zbatim të ndalesës nga Ministria e Brendshme. Ajo që Kosovës i ka dalë pak ndryshe është sjellja e zotit Gjuriq në Prishtinë edhe ai interpretimi se u bë një defilim te një natyrë e caktuar gjoja për Kosovën, mendoj se në Bruksel që i shohin zhvillimet ma ftoftë e që Gjuriqin e shohin si intelektual është ma vështirë", ka thënë Haradinaj, transmeton Periskopi.

Ai është pyetur nëse ka ndonjë qëndrim lidhur me deklaratat se ministri Rikallo është keq-trajtuar nga policia e Kosovës, kur 'në fakt ka qenë e kundërta'.

"Sa i përket asaj anës se si ka ndodhë, a ka tejkalim të veprimt gjatë operacionit e këto është Inspektorati i Policisë dhe të them të drejtën nuk kam të dhëna të mirëfillta, por është e kuptueshme me i drejtë dikujt një keqardhje në rast se ka ndodhë kjo", ka thënë Haradinaj.

Pas Erdoganit, Daçiq e pret me këngë edhe homologun grek Kotzias

Ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikos Kotzias gjatë udhëtimit të tij në Serbi është takuar me zyrtarë të lartë të këtij vendi. Por, gjatë takimit me homologun e tij serb Ivica Daçiq, Kotzias kishte pranuar të këndojë në duet një këngë greke. Nikoqiri e kishte ftuar në një drekë, ku derisa ishin ulur në tavolinë ata filluan të këndojnë këngën e



njohur të këngëtarit grek "Gorgos Dalaras "Do not Forget my Eyes". I emocionuar nga mikpritja e ngrohtë, Kotzias ishte ngritur në

këmbë që t'i bashkohet homologut serb me të cilin "argëtuan" të pranishmit tjerë.

Por, kjo nuk është hera e parë që shefi i diplomacisë së Serbisë u këndon politikanëve të huaj.

Vitin e kaluar gjatë vizitës zyrtare në Beograd të presidentit turk, Recep Tayyip Erdogan, Daçiq i kishte kënduar një këngë të vjetër turke.

'SYRIT TË POPULLIT' ME DYER TË MBYLLURA

Seanca fillestare e gjyqimit të dhjetë personave që akuzohen se i takonin organizatës "Syri i Popullit" e mbajtur të mërkurën ishte mbyllur për publikun. KALLXO.com ka siguruar aktvendimin e kryetares së trupit gjyqësor, gjyqtares Naime Krasniqi, me të cilin janë përshkruar arsyet e mbylljes së seancës për publikun.

Sipas aktvendimit të siguruar, shqyrtimi ishte mbyllur me qëllimin e "ruajtjes së informacionit të fshehtë".

"Përjashtohet publiku gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe atë pasi kemi të bëjmë me ruajtjen e informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohet nga shqyrtimi i hapur", thuhet në dispozitivin e aktvendimit të siguruar nga KALLXO.com.

Më tej, në dispozitivin thuhet se gjyqimi ishte mbyllur edhe "për të ruajtur jetën personale dhe fa-

miljare të Avni Llumnicës, i cili akuzohet edhe për dhunim".

Në përshkrim të aktvendimit thuhet se propozimi për mbylljen e shqyrtimit është bërë nga prokurori Sylë Hoxha, ndërsa është kundërshtuar nga mbrojtësit e të akuzuarve. Në këtë proces gjyqësor të akuzuar janë Murat Jashari, Avni Llumnica, Ragip Sallova, Sadri Ramabaja, Rexhep Topllana, Bajrush Konjusha, Sabit Berisha, Halim Halimi, Bexhet Luzha dhe Lirije Luzha. Prokuroria Speciale ngriti

aktakuzë ndaj tyre më 28 shkurt.

10 të akuzuarit ngarkohen për veprat penale hakmarrje në ndihmë, dhunim, përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve dhe hakmarrje. Sipas prokurorisë, të akuzuarit planifikonin shkatërrimin e strukturave themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës



së Kosovës me sulme dhe me vrasje ndaj personalitetëve më të larta shtetërore duke filluar nga ish-funksionarët e lartë të Kosovës prej vitit 1980 deri në 1991, duke i konsideruar si tradhtarë të vendit, e po ashtu funksionarët nga viti 1999 deri në vitin 2016.

KALLXO.com e kishte siguruar aktakuzën ndaj të akuzuarve si pjesëtarë të "Syrit të Popullit".

Sipas aktakuzës, organizata kishte grupe guerile, ndërsa kërkonte që Enver Hoxha të njihej si hero.

Murat Jashari, njërit nga të akuzuarit e këtij grupi i është caktuar trajtimi psikiatrik.

Murat Jashari e Avni Llumnica u arrestuan si të dyshuar për plagosjen e avokatit Azem Vllasi që ishte njëri nga udhëheqësit kosovarë të periudhës komuniste.

LOGJIKA E LUFTËS NË SIRI

SULM ME GAZ DHE BOMBARDIME

Një sulm me gaz nervor në qytetin e mbajtur nga rebelët, Duma e shkallëzoi situatën. Presidenti Trump kërcënon me raketa Sirinë dhe hedh shigjeta drejt Ruisë. Lufta në Siri po ndërkomëtarizohet gjithnjë e më shumë

Një "reagim të fortë të përba-shkët" bënë të ditur presidenti amerikana, Donald Trump dhe homologu i tij francez, Emmanuel Macron si reagim ndaj sulmit të dyshuar me gaz nervor në Duman siriane, ku humbën jetën të paktën 150 vetë, e 1000 të tjerë u plagosën. Regjimi i Asadit e mohon me vendosmëri se e ka kryer një sulm të tillë. Vetëm një ditë më vonë u sulmua aeroporti ushtarak, Taifour (T4) në provincën e Homsit, ku humbën jetën 14 vetë. Për autorin e sulmit spekulohet. Ishte kjo rastësi apo "reagimi i fortë" që bënë të ditur Trump dhe Macron? Presidenti amerikan, Donald Trump është shprehur, se kërkon të vendosë shpejt për përgjigjen amerikane.

Ndërkohë mediat siriane kanë fajësuar SHBA se është përgjegjëse për sulmin në Siri. Por Pentagoni e hodhi poshtë këtë. "Aktualisht Ministria e Mbrojtjes nuk po kryen bombardime në Siri." Vetëm pak më vonë, Rusia shpalli një përgjegjësi të mundshëm në lojë. Sulmi ka ardhur nga forcat ushtarake izraelite. Dy avionë izraelitë F15 kanë goditur nga hapësira libaneze me tetë raketa aeroportin, bëri të ditur Ministria e Mbrojtjes, sipas agjencive Tass dhe Inferfax.



SULM ME GAZ - VERIFIKIMI PUNË E LODHSHME HETIMI

Nëse ka një lidhje mes sulmit ndaj aeroportit dhe atij me gaz nervor nuk dihet. Vendosja e zinxhirit të kauzalitetit është problematike, sepse fillimisht duhet të vërtetohet sulmi me gaz nervor. Këtë detyrë e ka marrë përsipër Organizata për Ndalimin e Përdorimit të Armëve Kimike, OPCW. Por gjetja e provave për sulm me gaz është një ndërmarrje komplekse dhe e mundimshme.

Megjithatë rëndësi ka fillimi i hetimeve të menjëhershme, sepse shumë elementë në gazrat helmues shpërbëhen shpejt, shkruan eksperti për terrorizmin, Dan Kaszeta në faqen e rrjetit investigativ, "bellingcat". Përbërësit ose avullojnë shpejt, ose përzihen me elementë të tjerë. Gazi Sarin i përdorur

disa herë në luftën në Siri, ka cilësinë të avullojë më shpejt se uji. Kjo e bën shumë të vështirë identifikimin. Sarin dallon kështu nga gazi tjetër nervor, VX, që avullon shumë ngadalë dhe kështu mund të identifikohet më mirë.

Megjithatë hetuesit kanë shpresa, sepse ka shanse që disa përbërës të mos kenë avulluar. Disa përbërës gjenden të përthithur në tokë, në materiale të përdorura, apo në veshjet e viktimave, duke rezistuar kështu më gjatë. Njohuritë për proceset e avullimit të gazeve u japin ekspertëve mundësi të vazhdojnë hetimet. Kështu disa lloj gazrash shndërrohen në lëndë të tjera, prej të cilave mund të gjejsh origjinën e gazit. Po ashtu për shkak se gazrat nervorë përbëhen nga disa elementë, mund të gjendet gazi i përdorur edhe nga anali-

za e kombinimit të gjurmëve të mbetura, nënvizon Kaszeta.

NDËRKOMBËTARIZIMI I MËTEJSHËM I LUFTËS

Pak pas sulmit në Duma, edhe Turqia fajësoi regjimin e Asadit se ka përdorur gaz. Kjo nuk përjashtohet. Por kundër kësaj flet, që regjimi i ka mundur në masë të madhe rebelët, dhe bisedimet për tërheqjen e tyre gati janë mbyllur. Në këto kushte një sulm me gaz nervor do të ishte një provokim i panevojshëm.

Por i mundshëm është edhe një skenar tjetër: Lufta në Siri ka disa muaj që ka hyrë në një fazë të re. "Ajo po bëhet gjithnjë e më problematike, sepse rregullisht po futen nivele të reja konflikti", thotë Bente Scheller, drejtuese e Zyrës së Bejrutit të fondacionit Heinri-

ch-Böll-Stiftung. "Aktualisht po ndërhyjnë shumë aktorët rajonalë, Irani, Turqia, Izraeli." Në këto kushte, regjimi i Asadit mund të synojë që përmes një sulmi me gaz të përshpejtojë tërheqjen e tyre. Në negociatat e ardhshme, Asadi ka një pozicion më të mirë, sa më të mëdha të jenë fitoret ushtarake.

NUK PËRJASHTOHET IZRAELI SI SULMUES

Enjëta arsye - ndërkomëtarizimi i mëtejshëm i luftës, - të bënë që të duket logjike, që edhe Izraeli të mund të jetë përgjegjës për sulmin ndaj aeroportit Taifour. Kjo po të kujtosh, se ushtria izraelite ka pranuar më shumë se 100 bombardime në terrenin sirian. Izraeli është i alarmuar për shkak të forcimit të prezencës së Iranit dhe Hizbollahëve të lidhur me të. Ka fakte që disa luftëtarë të Hizbollahut janë parë në afërsi të kufirit izraelit. Në radion izraelite, Radio 103, ish-komandanti i aviacionit ushtarak izraelit, Ben Eliyahu ka thënë, se të flet shumë, që Izraeli është vendi që qëndron pas sulmit. "Të vetmit që mund ta sulmojnë Sirinë nga ajri janë amerikanët dhe izraelitët", citon Jerusalem Post bisedën në radio.

Eliyahu është shprehur edhe për sfondin e një sulmi të tillë, në rast se është kryer nga izraelitët. "Izraeli ka qëllimin që të bllokojë Iranin të vendoset në Siri." Kështu sulmi është paralajmërim tjetër ndaj regjimit sirian. Nëse i lejon Iranit shumë hapësirë në territorin e tij, kjo mund të sjellë tensione me Izraelin. Lufta në Siri po përhapet gjithnjë e më shumë. DW

AMERIKA DHE SITUATE NË SIRI

SHUMË OPSIONE, JO VETËM USHTARAKE

Kërcënimi përmes Twitterit i Donald Trump për sulm me raketa Sirisë alarmoi botën. Shtëpia e Bardhë u përpoq më pas të qetësojë situatën duke ofruar interpretime të ndryshme të mesazhit. Gjermania reagon e tronditur, raporton DW.

Sipas të dhënave nga zyra e Presidentit në Shtëpinë e Bardhë, presidenti Trump nuk ka ende një plan kohor për reagimin ndaj sulmit të mundshëm me gaz në Siri. Presidenti ka një sërë opsionesh, dhe këto nuk janë vetëm ushtarake, tha zëdhënësjja e tij, Sarah Sanders. Këto opsione po diskutohen. Por fillimisht do të vazhdohen bisedimet me partnerët si Izraeli, Arabia Saudite, Franca dhe Britania e Madhe.

Disa orë më parë, të mërkurën



(11.04) situata dukej ndryshe. Trump bëri të ditur përmes Twitterit një sulm me raketa në Siri. Raketat do të vijin dhe Rusia duhet të bëhet gati për këtë, shkroi presidenti amerikan. Trump bën përgjegjëse Ruisinë dhe Sirinë për

sulmin e mundshëm me gaz në bastionin e rebelëve, Duma. Moskë i hedh poshtë këto akuza. Presidenti Putin e vlerësoi gjendjen në botë si mjaft shqetësuese. Shpresoj të fitojë arsyeja, tha Putin. Kryeministria britanike, The-



resa May sipas mediave, po përgatit pjesëmarrjen e vendit të saj në një sulm të mundshëm kundër Sirisë. May zhvillon të enjten një seancë urgjente të kabinetit për gjendjen në Siri, bëri të ditur një zëdhënësi. Sipas Sky News ajo

kërkon të marrë miratimin e ministrave të saj për të dalë në krah të SHBA-së në sulmin në Siri. Sipas një medieje britanike, Londra vë në dispozicion nëndetëse për sulmin në Siri. Kërcënimi i Trumpit ndaj Sirisë dhe Ruisë ka shkakuar reagime të tronditura edhe në Gjermani. Politikani i Gjellbër, Jürgen Trittin deklaroi se "është e papërgjegjshme t'i deklarosh Ruisë luftën, në një kohë që është në rrugë Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike." Sipas Trittin kërcënimi i Trumpit ka të bëjë me presionin e brendshëm në Uashington.

Më shumë mirëkuptim për një sulm kundërpërgjigje të perëndimit ndaj Sirisë ka shprehur eksperti i CDU-së për politikën e jashtme, Roderich Kiesewetter, njofton DW.

SHOQATA AKCIONARE PËR MENAXHIMIN E HAPËSIRAVE AFARISTE
NË PRONËSI TË SHTETIT-SHKUPSHPALLJE nr.2 për dhënie me qira të hapësirave afariste në pronësi të Republikës së Maqedonisë
nëpërmjet ankandit elektronik publik (shpallje për herë të dytë)

LËNDA E ANKANDIT ELEKTRONIK PUBLIK

Lënda e ankandit elektronik publik është dhënie me qira e hapësirave afariste në pronësi të Republikës së Maqedonisë, sipas pasqyrës Tabelare në të cilën janë paraqitur të dhëna për numrin e parcelës kadastrale dhe komunës kadastrale ku gjendet lokali, numri i fletës së pronësisë, hapësira e lokalit afarist(m2), komuna, adresa ku gjendet lokali afarist, etazhi dhe numri i lokalit afarist, çmimi total fillestar, garancia bankare për seriozitetin e ofertës, afati për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje në ankandin publik dhe koha e fillimit të ankandit publik.

Në bazë të nenit 4 nga Ligji për blerje dhe dhënie me qira të ndërtesave, dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 13/13, 69/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15 dhe 61/15, 129/15, 6/16 dhe 106/16), si dhe Vendimit të Bordit të drejtorëve të Shoqatës akcionare nr.02-3885/6 nga 20.12.2017, lëndë e ankandit elektronik publik është hapësira afariste në vijim:

I. Shkup

numër rendor	Numri i kadastrës parcelës Komunës Kadastrë dhe fletë Pronës	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqja (m2)	Vlera e përgjithshme e parashikuar e lokaleve afariste (MKD)	Kostoja fillestare e qirasë mujore (në dinarë, pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës (%)	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në ankand publik	Filloni kohën e ankandit publik									
1	2	3	4	5	6	7	8	9									
1	13569 Qendër 1 100741	Qendër 11 Tetori nr.46 përdhese, hyr 1, zgjerim 2	92,00 (me ngarkesë)	6.787.923,00	33.940,00	135.758,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	03.05.2018 ora 09:00 (me ngarkesë)	23	315 K.Vodë 2 49005	Aerodrom Bul.K.J.Pitu nr.15 përdhese,hyr 1, zgjerim 12	18,00	1.544.047,00	7.720,00	30.881,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	09.05.2018 ora 12:00
2	13569 Qendër 1 100741	Qendër 11 Tetori nr.46 përdhese, hyr 1, zgjerim 3	80,00	5.803.381,00	29.017,00,00	116.068,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	03.05.2018 ora 10:30	24	315 K.Vodë 2 48985	Aerodrom Bul.K.J.Pitu nr.15 përdhese,hyr 1, zgjerim 13	22,00	1.910.462,00	9.553,00	38.210,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	09.05.2018 ora 13:30
3	13569 Qendër 1 100741	Qendër 11 Tetori nr.46 përdhese, hyr 1, zgjerim 1	80,00	5.154.115	25.771,00	103.082,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	03.05.2018 ora 12:00	25	315 K.Vodë 2 49402	Aerodrom Bul.K.J.Pitu nr.15 përdhese,hyr 1, zgjerim 13/III	22,00	1.910.462,00	9.553,00	38.210,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	09.05.2018 ora 15:00
4	13318 Qendër 1 54871	Qendër Koço Racin nr. 14 Garazhi nr. 108 a	14,00	476.744,00	2.384,00	9.535,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	03.05.2018 ora 13:30	26	315 K.Vodë 2 49030	Aerodrom Bul.K.J.Pitu nr.17 përdhese, hyr 1, zgjerim 18	13,00	1.092.324,00	5.462,00	21.847,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	10.05.2018 ora 09:00
5	2054/2 Qendër 1 104575	Qendër Cvetan Dimov nr.29 kat i ndërmjetëm,hyr 1, zgjerim 44	26,00	1.264.492,00	6.322,00	25.290,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	03.05.2018 ora 15:00	27	315 K.Vodë 2 48455	Aerodrom Bul.K.J.Pitu nr.17 përdhese,hyr 1, zgjerim 19	13,00	1.128.299,00	5.642,00	22.566,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	10.05.2018 ora 10:30
6	1071/1 Gazi Babë 9099	Gazi Babë Brigada Maqedonase 16 nr.2 përdhese, hyr 2, zgjerim 7	20,00	956.032,00	4.780,00	19.121,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	04.05.2018 ora 09:00	28	315 K.Vodë 2 48710	Aerodrom Bul.K.J.Pitu nr.17 përdhese,hyr 1, zgjerim 22	24,00	2.036.000,00	10.180,00	40.720,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	10.05.2018 ora 12:00
7	302/14 K.Vodë 2 106048	Aerodrom Vladimir Komarov 18 V bodrum, hyr 1, zgjerim 3	10,00	291.830,00	1.459,00	5.837,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	04.05.2018 ora 10:30	29	315 K.Vodë 2 48702	Aerodrom Bul.K.J.Pitu nr.17 përdhese,hyr 1, zgjerim 40	13,00	1.128.229,00	5.642,00	22.566,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	10.05.2018 ora 13:30
8	42 K.Vodë 2 57792	Aerodrom Vladimir Komarov nr.1 bodrum, hyr 1, zgjerim 1	365,00	9.872.392,00	49.362,00	197.448,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	04.05.2018 ora 12:00	30	315 K.Vodë 2 48980	Aerodrom Bul.K.J.Pitu nr.15 (B1-1) kat, hyr 1, zgjerim 3	265,00	13.131.608,00	65.658,00	262.632,00	17 ditë nga shpallja (30.04.2018)	10.05.2018 ora 15:00
Me aftësimin e kuadrit arsimor, u krijuan kushtet për zgjerimin e rrjetit shkollor fillor në gjuhën shqipe. Burimet arkivore bëjnë të ditur se në vitin shkollor 1945/46, në RP të Maqedonisë gjithsej funksiononin 1054 shkolla fillore, prej tyre 157 në gjuhën shqipe, 905 në gjuhën maqedonase, 62 në gjuhën turke dhe 11 në gjuhën serbo-kroate. Krahas shkollave, rritet edhe numri i nxënësve shqiptarë, i cili në atë vit shkollor arrin në 12.359 nxënës, nga gjithsej 111.196, ose mbi 10% nga numri i përgjithshëm.

Duhet të vëmë në dukje faktin se, në planprogramet të shkollave me mësim në gjuhën shqipe dhe turke, krahas historisë së kombeve jugosllave mësohej edhe historia e kombësisë shqiptare, përkatësisht turke. Mirëpo, kjo zgjat vetëm një vit shkollor, kur në gusht të vitit 1946, Ministria e Arsimit, përmes një qarkoreje njoftonte institucionet e atëhershme shkollore për ndryshimet në planprogramet mësimore në shkollat me mësim në gjuhën shqipe dhe ato turke. Në të shprehimisht thuhet: “Në planprogramet mësimore për shkollat e pakicave nga viti i kaluar qëndron se në lëndët e historisë dhe gjeografisë në ato shkolla do të mësohet historia dhe gjeografia e Jugosllavisë me historinë dhe gjeografinë e popujve që u takojnë pakicave. Kjo duhet të përmirësohet në atë mënyrë që edhe

IBRAIMI I LUMTUR ME KUALIFIKIMIN NË FINALE, TREGON OBJEKTIVIN

"Ne kishim vendosur paraprakisht këtë objektiv dhe deri tani kemi ecur mirë. Dëshironim finalen dhe të njëjtën duam ta fitojmë pa marrë parasysh kundërshtarin që kemi përballë. Neve na intereson vetëm fitorja dhe do të fokusohemi maksimalisht të shfaqim performancën më të mirë të mundshme për të fituar trofeun e Kupës, ashtu si që jemi në rrugë të mirë edhe në kampionat. Gjërat tjera janë të parëndësishme", pohon Ibraimi

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 12 prill - Skuadra e Shkëndijës ka bërë hapin e radhës drejt fitimit të dy trofeve në futbollin vendor, pasi me 18-të pikë epërsi në kampionat, të mërkurën kuqezinjtë siguruan kualifikim edhe në finalen e Kupës së Maqedonisë. Trofeu do të diskutohet përballë Pelisterit më 23 maj, një reprizë e finales së vitit të kaluar, në të cilën triumfoi skuadra nga Manastiri. Si zakonisht në qendër të vëmendjes në ndeshjen kthyesë ka qenë goleadori i kuqezinjve Besart Ibraimi, i cili shënoi dy gola. Ai për gazetën

DËSHIRONIM FINALEN DHE TË NJËJTËN DUAM TA FITOJMË



koha tregon emocionet e tij për golat dhe pritjet e tij në ndeshjen finale. "Jam i lumtur për kualifikimin në finalen e Kupës, ku do të kemi mundësi për të fituar trofeun. Gjithmonë më me rëndësi është suksesi kolektiv, megjithëse patjetër të pranoj se më vjen mirë që ky sukses u arrit pikërisht me golat e mi. Secili prej futbollistëve

është në funksion të ekipit dhe është mirë kur puna jote sjell sukses", shprehet Ibraimi, i cili pranon se objektivi i tij këtë sezon është fitimi i dy titujve. "Shkëndija ka objektiv fitimin e dy titujve në futbollin vendor dhe njëra prej to është Kupa. Ne kishim vendosur paraprakisht këtë objektiv dhe deri tani kemi ecur mirë. Dëshironim fi-

nalën dhe të njëjtën duam ta fitojmë pa marrë parasysh kundërshtarin që kemi përballë. Neve na intereson vetëm fitorja dhe do të fokusohemi maksimalisht të shfaqim performancën më të mirë të mundshme për të fituar trofeun e Kupës, ashtu si që jemi në rrugë të mirë edhe në kampionat. Gjërat tjera janë të parëndësishme", deklaroi sulmuesi kërçovar. Ndryshe, trajneri i Shkëndijës, Qatip Osmani beson se ekipi i tij është i aftë për të menaxhuar triumfin në finale. "Ishim përgatitur për këtë ndeshje të vetëdijshëm se nuk do t'i ngajë asaj të kampionatit që u vërejt. Kishim rezultat negativ dhe detyrimisht duhej të shënojmë për të kaluar në finale. Në pjesën e parë nuk mundëm të shënojmë dhe arsye ishte loja e ngadalshme. Në pjesën e dytë shënuam herët dhe kjo na mundësoi edhe golin e dytë. Sigurisht jemi të kënaqur me kualifikimin në finale dhe do të bëjmë çmos që të fitojmë trofeun e Kupës. Për mua është gëzim i veçantë sepse është trofeu i vetëm që më mungon dhe besoj se Shkëndija ka kualitet për të fituar Kupën", deklaroi trajneri Qatip Osmani.



Beari konfirmon largimin nga Renova

Shkup, 12 prill - Skuadra e Renovës pas trajnerit Vlatko Kostov, i cili dy ditë para ndeshjes kthyesë me KF Shkëndija në kuadër të Kupës së Maqedonisë dha dorëheqje dhe e njëjta u pranua nga stafi teknik, ka mbetur edhe pa ndihmësin e saj Dashmir Beari. Këtë lajm për gazetën KOHA e konfirmoi vet Beari. Ai konfirmon se dorëheqjen e bën tani zyrtare, por të njëjtën e ka dhënë dy orë pasi dha dorëheqje Kostovi. "Pas dorëheqjes së Kostovit realisht edhe unë vendosa të jap dorëheqje dhe të njëjtën ua konfirmova edhe drejtuesve të klubit. Kjo ndodhi në të njëjtën ditë, por vetëm dy orë pasi Kostovi konfirmoi dorëheqjen. Arsyeja për dorëheqjen time është morale, asgjë tjetër. Mendoj se nuk ishte njerëzore të vazhdoj të mbetem në klub", u shpreh për gazetën KOHA, Beari. Megjithatë edhe pas kësaj Beari do të qëndrojë te Renova, por me detyrë të re. "Unë në fakt kam dhënë dorëheqje nga posti i ndihmësit, mirëpo mbetem te Renova si koordinator i të rinjve, detyrë të cilën e kam ushtruar paralelisht derisa isha ndihmëstrajner", deklaroi Beari. Cekim, deri në gjetjen e trajnerit të ri, skuadrën e Renovës po e udhëheq Agron Mededi, ndërsa ndihmësi i tij do të jetë Kushtrim Abdullahi.

Tani kënaqem edhe thjesht të jem në fushë

Duhej të ishte viti i rikthimit të Shkëlzen Gashit, pas një sezoni zhgënjës në 2017-ën në MSL me Kolorado Rapids. Por edhe javët e para të këtij sezoni kanë qenë një makth i vërtetë për sulmuesin e përfaqësueses shqiptare. Ai kishte zhvilluar një fazë përgatitore të veçantë, duke synuar që ta niste në maksimum sezonin por dy dëmtime të njëpasnjëshme në pulpat e këmbëve bënë që Gashi të mos luante deri tani asnjë ndeshje me skuadrën e Kolorados. Futbollisti është kthyer më në fund në stërvitje me grupin këtë javë dhe si-



pas mediave amerikane, do të jetë i gatshëm që nga fundjava për të dhënë kontributin e tij në fushën e lojës. "Ishte situatë e vështirë pasi kisha punuar shumë për tre muaj

me radhë gjatë pushimeve. U ktheva në një formë të mirë fizike dhe thashë me vete 'këtë vit do të jem zjarr, do të jetë gjithçka mirë', tregoi i zhgënjyer lojtari. "Por ka të

bëjë tashmë me mentalitetin se si dëmtimet të bëjnë më të fortë. Në fund, ti fillon t'u gëzohesh gjërave të vogla përsëri, si faktit se thjesht kthehesh përsëri në fushën e lojës. Të jem i sinqertë, unë tani thjesht dua të jem në fushë. Mendoj se kur do të jem gati, mund të ndihmojë ekipin. Në 20-30 minutat e fundit të ndeshjes duhet të krijojmë më shumë shanse shënimi dhe unë do të jem gati të jap kontributin tim", tha Gashi, i ndërgjegjshëm se do të duhet shumë kohë derisa ai të cilësohet përsëri titullar të Kolorado Rapids.

RENDITJA E FIFA-S PËR MUAJIN PRILL

Kosova me rritje të jashtëzakonshme

Shkup, 12 prill - Përfaqësuesja e Maqedonisë në futboll gjendet në pozitën e 77-të në renditjen më të re të FIFA. Një rënie prej dy pozitave në krahasim me renditjen e muajit mars. Verdhekuqtë tani kanë 422 pikë, pasi në muajin mars dy herë luajtën baras në mini-turnirin në Antalia të Turqisë. Fillimisht luajtën 0-0 kundër Finlandës dhe më pas 1-1 kundër Azerbajxhanit. Ndryshe, Kombëtarja e Shqipërisë është ngjitur për

dy vende në renditjen mujore të FIFA-s. Tashmë kuqezinjtë janë në vendin e 56-të, por jo për meritën e tyre, sepse ata nuk kanë pasur rritje në pikë, por kanë përfutuar nga zbritja e theksuar e Bolivisë, por edhe Japonisë. Ndërkohë, ditë e shënuar për përfaqësuesen e Kosovës, sepse dy fitoret në miqësore kundër Burkina Fasos dhe Madagaskarit kanë vlejtur një rritje të jashtëzakonshme, plot 24 vende, duke kaluar nga vendi i 176-të

në atë të 152-të, një rekord. Ndërkaq, Gjermania mbetet e para dhe Brazili i dyti, por duke humbur pikë, ndërsa Belgjika kalon e treta, duke lënë pas Portugalinë e Argjentinën. Spanja zbrete teta në botë, duke u kaluar nga Zvicra dhe Franca. Vijnë pikiata e Italisë, tashmë e 20-ta në botë, 6 vende më pak se muaji i shkuar. Tunizia është e 14-të tashmë, me 9 vende më shumë se muaji i shkuar.



INSTITUCIONI PUBLIK KOMUNAL PËR FËMIJË – ÇERDHJA PËR FËMIJË
“DIMÇE MIRÇEV” – VELES PUBLIKON

SHPLLJE
PËR PRANIM TË PUNËTORËVE PËR KOHË TË PACAKTUAR

1. IPKÇF “Dimçe Mirçev” – Veles ka nevojë për punësim për orar të plotë të punës për kohë të PACAKTUAR edhe atë:

- EDUKATOR PËR FËMIJËT E MOSHËS PREJ 2 – 6 VJEÇARE..... 2 (DY) realizues;
- PËRKËDHËLËS..... 2 (DY) realizues;
- MIRËMBAJTËS TË HIGJENËS..... 1 (NJË) realizues;
- ENËLARËSE/SHËRBYESE.....1 (NJË) realizues;

2. Kushtet e nevojshme:

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligjin për mbrojtje të fëmijëve, kandidatët duhet të përbushin edhe kushtet në vijim:

Për vendin e punës edukator:

-Profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar të fëmijëve të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar shkalla e VII/1 ose arsim të mbaruar përkatës të lartë për edukator dhe licencë valide për edukator;

Orari i punës – javor 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte, orari ditëor i punës prej ora 07 -13,00, Neto pagesa fillestare: Me arsim sipëror...19.580,00; me arsim të lartë...18.514,00 denarë.

Për vendin e punës përkëdhelëse:

-arsim të mesëm të mbaruar katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës;

Orari i punës – javor 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte, orari ditëor i punës prej ora 09,00 - 17,00, Neto pagesa fillestare...14.920,00 denarë.

Për vendin e punës Mirëmbajtës të higjienës:

-arsim fillor të mbaruar ose arsim të mesëm;

Orari i punës – javor 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte, orari ditëor i punës prej ora 05,30 - 13,30 ose prej ora 09,30 - 17,30, Neto pagesa fillestare...12.005,00 denarë.

Për vendin e punës Enëlarëse/shërbyese:

-arsim fillor/të mesëm të mbaruar (gjimnaz, hotelieri).

Orari i punës – javor 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte, orari ditëor i punës prej ora 07,00 deri në ora 15,00, Neto pagesa fillestare...12.005,00 denarë.

Krahas kushteve të lartpërmendura, kandidatët duhet të përbushin edhe kushtet e posaçme në vijim: Shtetas i RM, i shëndosh fizikisht dhe psikikisht, nje gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtje-ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, të mos i jetë shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefnisor, për vepër penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese dhe të përbushë kushte të tjera të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës.

3. Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditëor, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.

4. Së bashku me fletëparaqitjen, të parashtrohet: diploma për arsimin e mbaruar përkatës në original ose kopje të vërtetuar në noter, licencë përkatëse valide në original, certifikatë të shtetësisë, dëshmi për masë të pashqiptuar për siguri nga Regjistri qendror dhe dëshmi se nuk është i dënuar nga Gjykata themelore jo më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj.

5. Dokumentacioni i kompletuar me fletëparaqitjen të parashtrihen në adresën: **IPKÇF “DIMÇE MIRÇEV” rr. Todor Hristov – Ificerçeto” nr. 1 në Veles, nr. i telefonit 043/231-226, personi për kontakt: Aco Petrushevski. 12.04.2018 Veles**

UD DREJTOR
Branislava Naceva

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e RM nr.5/02), dhe nenit 19-a, paragrafi 1 të Ligjit për ndërmarrjet publike (Gazeta zyrtare e RM nr. 38/1996; 9/1997; 6/2002; 40/2003; 49/2006; 22/2007; 83/2009; 97/2010; 6/2012; 119/2013; 41/2014; 138/2014; 25/2015; 61/2015 dhe 39/2016), Kryetari i Komunës së Gostivarit publikon:

KONKURS PUBLIK nr. 01/2018

për zgjedhjen e drejtorit të Ndërmarrjes publike për parkingjet publike dhe gjelbërimin - Gostivar

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 4 të Ligjit për ndërmarrjet publike, për drejtor të ndërmarrjes publike mundet të emërohet kandidati i zgjedhur përmes konkursit publik, që i plotëson kushtet si në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- ka aftësi të përgjithshme shëndetësore,
- ka së paku 240 kredi të fituara sipas EKTS ose shkallë të kryer arsimore VII/1;
- në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka minimum pesë vite përvojë pune,
- posedon një nga certifikatat ose vërtetimet e njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL iBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC Cambridge English: Legal – së paku niveli B2, FCE Cambridge English: First – të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë, dhe
- ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

Fletëparaqitje (formati i lirë) e cila duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e kandidatit, emërtimin e dokumenteve të dorëzuara dhe në shtojcë të fletëparaqitjes duhet të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm si në vijim:

- Biografi e shkurtër (C/V- curriculum vitae) me të dhëna për kontakt (adresa e vendbanimit ose e qëndrimit, telefon, e-mail),
 - Certifikatë për nënshtetësi (original ose kopje e vërtetuar në noter, jo më e vjetër se gjashtë muaj),
 - Diplomë për arsimimin e kryer, (original ose kopje e vërtetuar në noter),
 - Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, për ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (original ose kopje të vërtetuar në noter, jo më të vjetër se gjashtë muaj),
 - Dëshmi për përvojën e punës, (pasqyrë ose historiat nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor ose Qendra për punësim dhe dëshmi të tjera për përvojën e punës),
 - Certifikatë të njohur ndërkombëtarisht ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet,
 - Mendim profesional/Vërtetim për testin e dhënë psikologjik dhe testin për integritet.
 - Certifikatë mjekësore për aftësi të përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se gjashtë muaj, dorëzon vetëm kandidati i zgjedhur për drejtor, pas zgjedhjes.
- Dokumentet e nevojshme kandidatët duhet t'i dorëzojnë në afat prej 5 (pesë) ditë pune, nga dita e publikimit të konkursit në shtypin e përditshëm, duke mos llogaritur ditën e publikimit. Dokumentet mund të dorëzohen personalisht në arkivin e Komunës së Gostivarit ose përmes postës në adresën: Komunës së Gostivarit, Bul.B.Gjinovski nr. 61, 1230 Gostivar, me shënimin: "Për konkursin për zgjedhjen e drejtorit të Ndërmarrjes publike për parkingjet publike dhe gjelbërimin - Gostivar. Zgjedhja e kandidatit do të bëhet më së voni në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas kalimit të afatit për kontrollimin e dokumentacionit dhe selektimit administrativ. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara me vonesë, nuk do të shqyrtohen nga ana e Komisionit për kontrollimin e dokumentacionit dhe selektimit administrativ.

Kryetari i Komunës së Gostivarit, Arben Taravari

Në bazë të Programit për financim të aktiviteteve dhe projekteve të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve për vitin 2018 në Komunën e Çairit ("Fleta zyrtare e Komunës së Çairit nr. 4/2018) Komuna e Çairit shpall

Thirrje publike

Për pranim të kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga buxheti i Komunës Çair për vitin 2018, të dedikuara për financim të projekteve dhe aktiviteteve të OJQ, Shoqatave dhe Fondacioneve për vitin 2018 në Komunën e Çairit. Shpërndarja e mjeteve realizohet nga buxheti i Komunës Çair për vitin 2018 dhe në pajtim me Programin për financim të aktiviteteve dhe projekteve të OJQ, Shoqatave dhe Fondacioneve për vitin 2018 në Komunën e Çairit.

Fusha e projekteve të cilat do të mbështeten:

Mbrojtje sociale
Kulturë
Sport
Mjedis jetësor
Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik
Arsim

Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjes:

Shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet mund të dorëzojnë vetëm një kërkesë për mbështetje financiare për projekt ose manifestim.

Të dhënat e nevojshme si dhe propozim projektet dhe aktivitetet, me konstruksion financiar, duhet të dorëzohen në fletëparaqitje të veçantë, e cila mund të merret në Arkivin e Komunës së Çairit ose në faqen zyrtare të Komunës së Çairit www.cair.gov.mk.

Thirrja publike zgjat 10 ditë, nga dita e shpalljes në mjetet për informim publik.

Fletëparaqitjet duhet të dorëzohen deri te Komuna e Çairit, përmes postës në adresën: H.T. Karposh nr. 5, 1000 Shkup, ose në arkivin e Komunës së Çairit më së voni deri në orën 15, në ditën e fundit të përfundimit të Thirrjes publike, me shënim **Thirrje publike për shpërndarje të mjeteve buxhetore për financim të aktiviteteve të OJQ-ve, shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve për vitin 2018 në Komunën e Çairit.**

Rezultatet e Thirrjes publike do të shpallen në faqen zyrtare të Komunës së Çairit.

Shfrytëzimi i mjeteve të dhuruara do të specifikohet me nënshkrimin e kontratës mes shoqatës/fondacionit dhe Komunës së Çairit.

Vërejtje: Fletëparaqitja me dokumentacion jo të plotësuar ose pas skadimit të afatit të caktuar nuk dë të shqyrtohet!

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15 – tekst i pastruar), nenit 80 dhe nenit 82 të Ligjit për arsim fillor dhe pëlqimit nga MASH, SHFQ “Hristo Uzunov” – Drugovë, publikon

SHPLLJE

Për themelimin e marrëdhënies së punës për kohë të caktuar të punës në SHFQ “Hristo Uzunov” – Drugovë për vitin shkollor 2017/2018 deri në kthimin e drejtorit në vend të punës, edhe atë:

1. Një mësimdhënës të mësimit klasor me orar të plotë të punës (zëvendësim për drejtorin). Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim fillor, si dhe kushtet e parapara me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës.

Pagesa fillestare për punëtorin nga pika 1 është 22.018,00 denarë;

Orët javore për punë do të jenë prej ditës së hënë deri ditën e premte, orët e punës do të realizohen në një ndërrim: prej ora 13:30 deri në ora 17:20 deri në përfundim të orarit të orëve në shkollë për vitin shkollor 2017/2018.

Dokumentet e nevojshme:

- Lutje;
- Dokument (diplomë) për arsimin e mbaruar përkatës, në original ose kopje të vërtetuar në noter;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Certifikatë të lindjes.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 5 ditëve të punës pas përfundimit të shpalljes.

Dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri në SHFQ “Hristo Uzunov” – Drugovë.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

SHFQ “Hristo Uzunov” – Drugovë

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gaz. Zyrtare e RM. nr. 74/15), pëlqimit të dhënë nga MASH nr. 12 – 2064/2 prej 02.03.2018, pëlqimit nga MASH Nr 12 – 1847/2 prej 22.02.2018, pëlqimit nga MASH Nr 12 – 1053/1 prej 25.01.2018, pëlqimit nga MASH Nr 12-595/5 prej 14.03.2018, Mendimit pozitiv për Planin e punësimit për vitin 2018 nga MSHA Nr 12/6 – 1878/3 prej 11.04.2018 si dhe sistematizimit të vendeve të punës, U.D Drejtori i Sh.F. “LIRIA” fsh. Jabollçisht i Epëm komuna e Çashkës, shpall këtë

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës me kohë të pakufizuar dhe të kufizuar deri më 31.08.2018 për vitin shkollorë 2017/2018 (orar i plotë)

I ShF “Liria”Jabollçisht i Epërm me mësim në gjuhë shqipe

1. Arsimtar i grupit klasorë - 1 realizues deri më 31.08.2018
2. Arsimtarë të gjuhës angleze - 2 realizues – zëvendësim / pushim lindje
3. Shërbëtorë - 2 realizues – kontratë me afat të pakufizuar

II Shp-Jabollçisht i Poshtëm me mësim në gjuhën shqipe

1. Shërbëtorë - 1 realizues - kontratë me afat të pakufizuar

Kushtet: Krahas kushteve të parapara me LMP kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet në përputhje me nenin 80 nga Ligji për arsim fillor (Gaz. Zyr e RM. 103/08)

Konkursi do të jete i hapur 5 (pesë) dite pune nga dita e shpalljes

Dokumentet e nevojshme:

1. Lutje
2. Diploma për arsimin adekuat
3. Certifikata e shtetësisë të RM

Dokumentacioni i pakompletuar dhe jo në kohe të dorëzuar nuk do të merret në shqyrtim

Kandidatët dokumentet të dorëzojnë në adresën: Shkolla fillore “Liria”

Fsh. Jabollçisht i Epërm –Komuna e Çashkës Tel. 043/244 501 mob. 070742995

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15 dhe 27/2016), dhe nenit 82 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare nr. 103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 06/12, 100/12, 24/13, 41/2014, 116/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017), dhe në pajtim me lajmërimin e marrë nga Ministria e arsimit dhe shkencës nr. 12-1990/2 të datës 02.03.2018 dhe Pasqyrës nr. 1 për punësim për kohë të caktuar SHFK "Vojdan Çernodrinski" – Shkup, publikon

SHPALLJE
Për plotësimin e vendeve të punës
për kohë të caktuar për vitin shkollor 2017-2018

SHFK "Vojdan Çernodrinski" – Shkup për vitin shkollor 2017-2018 ka nevojë për: Mësimdhënës të mësimt klasor për kohë të caktuar si zëvendësim të mësimdhënës në pushim të lindjes deri në kthim të personit nga pushimi i lindjes, ndërsa më së voni deri më 31.08.2018. Mësimdhënësit e mësimt klasor janë me orar të plotë të punës prej ora 08:00 deri në mbarimin e orëve mësimore, në ditët prej ditës së hënë deri ditën e premte, me fond të plotë të orëve, me shkallë VII/1 të arsimit (Profesor i diplomuar për mësim klasor ose Pedagog i diplomuar) . Mësimdhënësit kanë të drejtë për pushim ditor, javor dhe vjetor në pajtim me LMP dhe neto pagesë themelore prej 20.644,00 denarë. Punëtorët kanë të drejtë për pushim ditor, javor dhe vjetor në pajtim me LMP. Përpos kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, kuadri mësimor dhe bashkëpunëtorët profesional duhet ti plotësojnë edhe kushtet e parapara në nenin 77 dhe nenin 80 nga Ligji për arsim fillor.

Së bashku me lutjen duhet të dorëzohen dokumentet në vijim:

- CV
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- diplomë për arsim të mbaruar përkatës
- të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik
- të ketë të dhënë provimin profesional për mësimdhënës, bashkëpunëtor profesional gjegjësisht edukator, (me përjashtim të kandidatëve të cilët e kanë statutin e praktikantit)

Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në SHFK "Vojdan Çernodrinski" – Shkup rr. Drezdenska" nr. 3, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter. Personi për kontakt: Verica Llazarevska Trpovska, tel. 02/ 3066-610.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit, ndërsa zgjedhja do të bëhet në afat prej 20 ditëve të punës pas përfundimit të shpalljes. Dokumentacioni i pakompletuar dhe i dorëzuar pas afatit nuk do të merret parasysh.

Drejtor
Hristina Ristevska

Në bazë të nenit 135 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008; nr. 103/2008; nr. 26/2009; nr. 83/2009 dhe nr. 99/2009; nr. 115/2010, nr. 17/2011, nr. 51/2011, nr. 123/2012, nr. 15/2013, nr. 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016, 127/2016), Dekani i Fakultetit Filozofik në Shkup, publikon

KONKURS
për zgjedhje të:

1. Një mësimdhënës (në të gjitha titujt mësimor-shkencor) në sferat shkencore (disiplinat), në pajtim me Klasifikimin e grupeve, fushave dhe sferave shkencore (disiplinave), sipas standardeve të OECD: **Psikologjia klinike (shifra 51001), Psikologjia e këshillimit (shifra 51003).**
2. Një mësimdhënës (në të gjitha titujt mësimor-shkencor) në sferat shkencore (disiplinat), në pajtim me Klasifikimin e grupeve, fushave dhe sferave shkencore (disiplinave), sipas standardeve të OECD: **Filozofia e religjionit (shifra 60514), Të tjera (shifra 60517).**

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë, Statutin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunës dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe: fletëparaqitje për pjesëmarrje në konkurs, biografi të shkurtër, dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të LMP (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015), Drejtori i SHFK "Petre Pop Arsov" Bogomila Komuna Çashka më datë 10.04.2018 ka sjellë Vendim për publikim të

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të personave për kohë të caktuar të punës për vendet e punës në vijim

1. Mësimdhënës të edukatës muzikore (4) katër orë dhe (3) tre orë orkestrë.
2. Mësimdhënës të matematikës dhe fizikës (17) shtatëmbëdhjetë orë matematikë dhe (4) katër orë fizik në SHFK "Petre Pop Arsov" Bogomilla.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara e ligjin për marrëdhënie pune.

- Të kenë arsim përkatës.
- Të jenë shtetas të RM.

Dokumentet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditë pas përfundimit të shpalljes.

Drejtor,
/Margica Xhunova/

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare nr. 52/2012) dhe Pëlqimit për punësim nr. 12-10951/8 të datës 25.01.2018 nga MASH dhe Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 02-152/1 të datës 12.04.2018, SHFK "Johan Hajnrh Pestaloci" – Qendër publikon

SHPALLJE
Për punësim të kuadrin jomësimor për kohë të pacaktuar

1. Punëtor për mirëmbajtje të higjienës me orar të plotë të punës për kohë të pacaktuar – 2 (dy) realizues;

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet në vijim:

- të ketë të mbaruar arsimin fillor
- të jetë shtetas i RM
- të ketë të moshës së rritur

Orari i punës së punëtorëve për mirëmbajtje të higjienës është 40 orë pune në javë, me dy ndërrime të orarit ditor të punës edhe atë: ndërrimi i parë prej ora 6:00 deri në ora 14:00 dhe ndërrimi i dytë prej ora 12:00 deri në ora 20:00.

Shuma në të holla e pagesës neto - 12,000,00 den.

Kandidatët duhet të parashtrijnë:

- Fletëparaqitje/Lutje
- Dëshmi për arsim të mbaruar;
- Certifikatë të shtetësisë;

Dokumentet duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

2. Punëtor për vendin e punës mjeshtrë të përgjithshëm me orar të plotë të punës për kohë të pacaktuar -1 (një) realizues)

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet në vijim:

- të ketë të mbaruar arsimin fillor/të mesëm
- të jetë shtetas i RM
- të jetë i moshës së rritur

Orari i punës së mjeshtrit të përgjithshëm është 40 orë pune në javë ndërrimi i parë prej ora 6:00 deri në ora 14:00

Shuma në të holla e pagesës neto - 14,900,00 den.

Kandidatët duhet të parashtrijnë:

- Fletëparaqitje/Lutje
- Dëshmi për arsim të mbaruar;
- Certifikatë të shtetësisë;

Dokumentet duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Afati për paraqitje është pesë (5) vjet pune nga dita e publikimit të shpalljes.

Zgjedhja e kandidatëve sipas shpalljes publike do të realizohet në afat prej 30 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen deri në SHFK "Johan Hajnrh Pestaloci" rr.

"Apostoll Gusllarot" nr. 3 – Komuna Qendër, Shkup

Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

SHFK "Johan Hajnrh Pestaloci" - Shkup

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 74 të vitit 2015) dhe nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 100/2012, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/2017), si dhe në bazë të pëlqimit të marrë nga MASH nr. 04- 49/1 të datës 05.02.2018 dhe nr. 04-83/1 të datës 06.03.2018 dhe vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 04- 130/1 të datës 12.04.2018, U. D. Drejtori i SHFK "Kire Gavrilloski – Jane" Prilep, publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për nevojën e punëtorëve

Publikohet shpallje për praninë të punëtorëve për vendet e punës në vijim:

1. Një (1) mësimdhënës të mësimt klasor për kohë të caktuar të punës me orar të plotë të punës (zëvendësim të u.d drejtorit) më së voni deri më 31.08.2018;
2. Një (1) rojtar – sigurim të objekteve dhe pajisjeve për kohë të pacaktuar të punës me orar të plotë të punës;

Kandidati me numër rendor 1 krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, duhet të përmbushin edhe kushtet nga neni 80 dhe 82 i Ligjit për arsim fillor dhe të kenë të mbaruar arsimin përkatës sipas normativit për kuadër mësimor.

Kandidati me numër rendor 2 të përmbushë kushtet në vijim:

- Të ketë të mbaruar arsimin e mesëm të shkallës IV

Dokumentet e nevojshme:

- Kërkesë për punësim sipas shpalljes;
- Kopje të Diplomës ose certifikatës për arsimin e mbaruar përkatës të vërtetuar në noter ose origjinal;
- Certifikatë të shtetësisë jo më të vjetër se 6 muaj.

Për vendin e punës me numër rendor 1 orari i punës është me ndërrime sipas orarit të orëve, në pajtim me orarin e orëve mësimore nga Programi vjetor për vitin shkollor 2017/2018. Neto pagesa fillestare është 20.657,00 denarë.

Për vendin e punës me numër rendor 2 orari i punës është në pajtim me Rregulloren për sistematizim të atij vendi të punës. Neto pagesa fillestare është 15.200,00 denarë.

Shpallja zgjatë pesë (5) ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 45 ditëve.

Dokumentet e arritura pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri në arkivin e SHF "Kire Gavrilloski – Jane" rr. "Joska Jordanoski" nr. 46, Prilep, tel. për kontakt 048/427-604.

U. D DREJTOR
Keti Stevananhia

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar Po + Pr + 2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë "Momin Potok" – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m2 së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m2. Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup nr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Koha <http://www.koha.mk>

www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdheshë, Shkup

Padyshim që ishte një ndeshje që ka për të mbetur gjatë në memorien e tifozëve të futbollit. Një ndeshje që do të përflitet për ditë të tëra në vazhdim për shkak të episodeve të shumtë që kishte në vetëm 5 minutat e fundit të sfidës mes Real Madridit dhe Juventusit

Real Madridi ka shpëtuar për mrekulli në sekondat e fundit duke shmangur shtesën pasi Juventusit përmbysi disavantazhin e ndeshjes së parë me dy golat e kroatit Manxhukiq dhe Matuidi. Ishte një ndeshje e mrekullueshme në "Bernabeu" dhe me një nga fundet më dramatike të historisë së futbollit e cila u mbyll me rezultatin 3-1 në favor të italianëve. Padyshim që është një ndeshje që ka për të mbetur gjatë në memorien e tifozëve të futbollit. Një ndeshje që do të përflitet për ditë të tëra në vazhdim për shkak të episodeve të shumtë që kishte në vetëm 5 minutat e fundit të sfidës mes Real Madridit dhe Juventusit. Kur dukej sikur ndeshja do të shkonte në kohën shtesë pasi Juve kishte përmbysur disavantazhin e ndeshjes së parë, Benatia shtyn në Vazkuez brenda zonës dhe arbitri akordon një penallti. Lojtarët e Juventusit çmenden me vendimin duke protestuar në mënyrë agresive drejt Mikael Oliver, i cili pak më pas nxjerr me karton të kuq Buffon. Kaos, Allegri që konfrontohet me Ramosin, ndërsa media italiane dhe spanjolle konfrontohet në tribunë. "Ai tha se ishte penallti dhe unë i thashë se në ndeshjen e parë kishte një penallti për be. Por, pasi pa faullin ndaj Kuadrados, arbitri sinjalizoi fundin e ndeshjes. Ramos bëri sikur nuk kuptoi dhe nuk foli më", ka zbuluar debatin me Ramosin, trajneri i Juves, Allegri. Pas largimit të Buffon, në fushë futet portieri i dytë Sçesni, por Ronaldo ishte i sigurt dhe i dha fitoren Realit duke kaluar në gjysmëfinale.

BUFFON SULMON ARBITRIN

Ndryshe, pas përfundimit të ndeshjes Xhanluigji Buffon, nuk i ka kursyer kritikën ndaj arbitrit që akordoi penalltinë në favor të Real Madridit. Një penallti që u transformua në gol nga Ronaldo dhe eliminoi torinezët nga Liga e kampionëve. "Ishte një aksion i dyshimtë në minutën e 95-të, – ka thënë Buffon, – një arbitër nuk mund të vendosë eliminimin e një skuadre në këtë mënyrë. Çfarë kenë vend të zëmres? Një kosh plehrash... Nëse nuk je në nivelin e duhur për ndeshje të tillë, atëherë rri në shtëpi me gruan, ose në tribunë", deklaroi Buffon. Në anën tjetër mbrojtësi Kielini bëri një gj-

RONALDO SHPËTON REALIN, BUFFON SULMON ARBITRIN



JUVENTUSI ELIMINOHET MES POLEMIKAVE



Mehdi Benatia

SHTYPI: "GRABITJA E SHEKULLIT", "GABIMI I EPOKËS"

Penallti apo jo? Mëngjesin e ditës së djeshme, pas ndeshjes dramatike Real Madridi-Juventus, në të gjithë Evropën nuk flitet për asgjë tjetër, përveç episodit të penalltisë, që kaloi në gjysmëfinale të Çampionit skuadrën e Zidane, ndërsa hodhi në erë përmbysjen historike të bardhezinjve në "Bernabeu". Edhe faqet e para të gazetave në kontinentin tonë janë të ndara në gjykimin e episodit, që i eliminoi kampionët e Italisë nga Liga e Kampionëve. Ja qëndrimet e mediave kryesore evropiane:

Tuttosport (Torino, Itali). "Paraqitje e jashtëzakonshme, një Juventus i madh. Një përmbysje spektakolare. Në shtesën e kohës së rregullt, arbitri akordon një penallti të diskutueshme. Protesta e Buffon solli edhe dëbimin e tij me karton të kuq".

"Corriere dello Sport" (Romë, Itali): "Kush e vodhi Juventusin? Një penallti që nuk ekzistonte në minutën e 93-të mohon



përmbysjen heroike kundër Realit".

"La Gazzetta dello Sport" (Milano, Itali): "Zemërim dhe krenari, Juventus i jashtë. Dominoi ndaj Real Madridit, por vetëm për një penallti shumë e dyshimtë në minutën e 97-të vulosi kualifikimin. 3-1 dhe lamtumirë Champions".

"L'Equipe" (Francë): "Kualifikimi i Real Madridit eklipsohet nga një Juve e madhe. Bardhezinjtë

zhvlerësuan mrekullisht disavantazhin 3-0 të ndeshjes së parë, por në kohën shtesë, Ronaldo ka konvertuar në gol një penallti të kontestuar".

"The Times" (Angli): "Ronaldo thyen zemrat e Juventusit. Buffon dërgohet jashtë nga një arbitër britanik, që dha një penallti të diskutueshme të vonë. Real Madridi fitoi 4-3 në total, pas një përmbysje tronditëse italiane".

st kundrejt futbollistëve madrilen, respektivisht Marselos duke i thënë se e kanë blerë ndeshjen 'you pay' duke i bërë gjestin e parave.

RONALDO: NUK E KUPTOJ PSE PROTESTUAN, ISHTE PENALLTI

Autori i golit të fitores për Realin, Cristiano Ronaldo deklaroi se skuadra e tij është shumë e lumtur

për kualifikimin në gjysmëfinale, kurse për penalltinë e akorduar në minutën e 90+3, thotë se nuk e kupton pse lojtarët e Juventusit protestuan, e sipas tij ajo ishte penallti e pastër. "Nuk e kuptoj pse ata protestuan. Lukas u shty nga prapa, ishte penallti. Real Madridi është shumë i lumtur. E dija se ishte vendimtare, dhe falë zotit që shënova", ka deklaruar Ronaldo. Ai

më tutja ka shtuar se, "ishte një përjetësi derisa e mora penalltinë, kjo është një ndeshje prej së cilës duhet të mësojmë, asgjë në futboll nuk të jepet. Le të jetë një mësim, ata ishin shumë të mirë". "Jam i kënaqur, për 180 minuta ne merituar të shkojmë tutje. Patëm shumë raste sot, por topi s'donte të hynte, dhe duhej të vuanim", ka deklaruar Zidane.

Unë u rrotullova që të evitoja përplasjen por ai nuk mund të bënte gjë tjetër veçse të mendohej të rrëzohej. Më vjen keq për provën e mirë që dhuruam, por jam krenar që u bëra pjesë e kësaj ndeshje. Nga pamjet duhet qartë që mundohem ta evitoj, pastaj nuk di të them nëse e kam prekur me kofshë apo jo. Ndoshta po, por në sekondën e fundit është absurde të vëshllesh një penallti të tillë. Por sot jemi viktimë të një gjëje të tillë. Unë me këmbën e majtë prek topin. Të vjen keq, pasi ka ndodhur edhe vitin e kaluar me Bajernin. Çdo vit e njëjta histori. Reali nuk ka nevojë për një favorizim të tillë

BAJERNIT I MJAFTON BARAZIMI

Bajern Munihu është kualifikuar në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve më vështirë se që ishte menduar pasi një barazim pa gola i ka mjaftuar gjermanëve për të eliminuar Seviliën me rezultat të përgjithshëm (2-1) pas dy ndeshjeve. Bajernit kështu i mjaftoi performanca nga ndeshja e parë, ndërkaq, Sevilija tregoi edhe një herë pedigree evropiane dhe eliminohet kokëllartë pas një lufte dinjitoze të shfaqur në dyja ndeshje.

Ku shkoi gjysmë toni hashash? Policët: E hëngrën minjtë!

Që minjtë të hanë gjysmë ton marijuanë pa i gjetur asgjë nuk ishte dëgjuar më parë, por ja që kë shtu pretendojnë tetë policë të shkarkuar në Argentinë, për zhdukjen e kësaj sasi nga magazinat e sekuestrimit të policisë. Një inspektim në policinë afër Buenos Aires tregoi se në magazinën e sekuestrimeve mungonte një sasi prej 540 kg marijuanë nga 6 mijë që ishin regjistruar dy vite më parë. Komisioneri i inspektimit Javier doli para gjyqtarit bashkë me 7 po-

licë të tjerë që thanë se marijuanën e zhdukur e hëngrën minjtë. Megjithatë ekspertët dyshojnë për aftësinë e minjve për të ngrënë një sasi kaq të madhe dhe nuk janë gjetur të ngordhur vërdallë. Specialistët e mjekësisë ligjore nga Universiteti i Buenos Aires-it kanë testuar se minjtë nuk mund të ngatërrojnë drogën me ushqimin. Dyshimet bien mbi Specia-n pasi ai e la të hapur inventarin e marijuanës para se të linte detyrën në prill të 2017.



Rita shtyn sërish lansimin e albumit të ri

Albumi i dytë i Rita Orës është shtyrë sërish. Disa herë Rita Ora ka treguar për vështirësitë për lansimin e albumit të dytë, pasi që dihet se albumi i parë "ORA" ishte lansuar para gjashtë viteve. Pas lajmëroi kohë më parë se albumi do të lansohej në pranverë, "Glamour Magazine Germany" raporton se ai është shtyrë për në vjeshtë. Sipas raportimit, "albumi duhet të kompletet me gjithçka që meriton për t'u lansuar". Rita ka udhëhequr disa herë së fundmi në top-lista botërore. Ajo kishte nisur tentativën për lansimin e albumit të dytë qysh më 2014, por pas problemeve me Calvin Harrisin dhe më pas me "Roc Nation" u detyrua të shtynte punët për më vonë.

Çifti kinez bëhen prindër katër vjet pas vdekjes

Një çift i ri kinez kishte vdekur në vitin 2013 në një aksident komunikacioni, por mrekullia ndodhi pas katër vjetëve, pasi lindi fëmija i tyre. Nëse jeta është shkruar si në një roman, është rasti i dy familjeve kineze që gjetën një mënyrë të pabesueshme për të ruajtur pemën e tyre familjare. Çifti i ri kinez kishin humbur jetë vetëm pesë ditë para transplantimit të planifikuar të embrioneve të krijuara nga fekondimi in vitro. Familjarët e çiftit të vdekur gjetën një nënë surrogate për të transplantuar embrionin e çiftit dhe gjyshërit janë mese të lumtur që në jetë ka



ardhur një djalë, të cilët deklaruan se nuk do t'ia thonë të vërtetën deri sa të rritet për të kuptuar realitetin.

Sa më aktivë që janë prindërit, aq më inteligjentë janë fëmijët e tyre!



Prindërit që ushtrojnë mund të nxisin inteligjencën e gjeneratave të ardhshme, thekson një hulumtim i ri. Këtë e dëshmon një studim i ri gjerman bërë në minjtë aktivë, ndërsa është hasur në ta

më shumë inteligjencë tek pasardhësit e tyre. Pasardhësit e tillë gjithashtu kanë komunikim më të mirë midis qelizave në rajonet e trurit të tyre përgjegjës për marrjen e informacionit të ri, shton hulumtimi, i cili njihet si hippocampus. Ushtrimi mendohet të rrisë inteligjencën e minjve duke ndryshuar ADN-në në spermatozoidët e tyre, sipas studiuesve. Të gjeturat e mëparshme sugjerojnë se aktiviteti përmirëson kujtimet e njerëzve, produktivitetin dhe aftësitë vendimmarrëse duke rritur nivelet e oksigjenit në trurin e tyre por jo dhe inteligjencën.

Këto kufje pastrojnë veshët për 35 sekonda!

Një kompani ka krijuar kufje që mund të pastrojnë dyllin nga veshët e një personi në 35 sekonda. Këto kufje zëvendësojnë pambukun e dëmshëm dhe vizitat e kushtueshme tek mjeku. Nisja me bazë në Seattle SafKan zhvilloi një pajisje që mund të pastrojë të dy veshët

njëkohësisht brenda një minute duke injektuar një përzierje të peroksidit të hidrogjenit në veshin për të shkrirë dyll përpara se të thithë atë. Miliona njerëz në botë përjetojnë dyllin e tepërt të veshit ose të ndikuar që mund të shkaktojnë dhimbje, humbje të dëgjimit, pro-

bleme të balancimit dhe probleme të tjera shëndetësore. Tentimi për të hequr dyllin e veshit me këshilla mund të shkaktojë edhe më shumë dëmtime në lëkurën delikate të veshit dhe potencialisht të çojë në ndonjë dëmtim të shqisave të veshit.



989 – Beteja e Abajdos: Perandori bizantin Basili II mund Bardas Fokas 1055 – Peshkopi Gebhart van Aihsthat emërohet si Papa Viktori II
1241 – Beteja e Theisit: Mongolët mundin Mbretin hungarez Bela IV
1250 – Kryqëzata VII pëson disfatë në Egjipt, Luigji IX zihet rob
1346 – Papa Klementi VI shpall Perandorin gjerman Luigjin e Bavarisë për lajmëtar
1367 – Beteja e Naheras Spanjë: Kastilja dhe Anglia mundin Aragonin dhe Francën
1517 – Armata osmane okupon Kairon
1556 – Portugezi Marranos i cili kthehet prap në Judaizëm ndizet i gjallë me urdhërin e Papës
1759 – Franca mund Aleancën evropiane në betejën e Bergenit
1796 – Arrinë elefanti i parë në Amerikë nga India
1796 – Beteja e Miliesimos Itali: Napoleoni mund austriakët
1849 – shpallet Republika e Hungarisë

Armata e shtetit të Vatikanit është armata më e vjetër në botë. Zyrtarisht është themeluar më 21 janar 1506, por fillimet e saj shënohen që në vitin 1400. Përveç se është armata më e vjetër në Botë, ajo është edhe ndër më të voglat, me vetëm 83 ushtarë. Uniformat e tyre kanë qenë të dizajnuara nga artisti gjeneral Mikelanxhelo.



Qyteti i parë në botë që njihet të ketë kaluar shifrën e mbi 1 milion banorëve ka qenë Roma (në vitin 133 para e.r.), më pas Aleksandria në Egjipt (në vitin 30 para e.r.). Ndërsa Londra e ka kaluar këtë shifër vetëm në vitin 1810, Parisi në vitin 1850 dhe Nju Jorku në vitin 1874.



Gënjeshtër

Një doktor pyeti pacientin e tij: Pi duhan?
Pacientin: Jo
Doktori: E pinë alkoolin?
Pacientin: Jo
Doktori: Po ti nuk paske asnjë ves
Pacientin: E kam një
Doktori: Çfarë?
Pacientin: Gënjej...



Nuk është mungesa e dashurisë, por mungesa e miqësisë është ajo që i bën martesat e palumtura.

(Friedrich Nietzsche)



KALENDARI HISTORIK 13 PRILL



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS